Activity 1.3.2 - Development of a comprehensive Youth-friendly services guide

Subject	Best Practices Research Report produced with successful models from selected countries, analysed and contextualized for Albania (in Albanian).
Identification Number	EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084
Date	various
Venue	Project Office, NYA Tirana, Albania
Activity code	1.3.2 - Development of a comprehensive Youth-friendly services guide
Authors	KE-2 Bernard Zeneli Sr NKE Youth Policy Anisa Seferaj
Revised by	KE-1 Cleofe MC Guardigli

RAPORT KËRKIMOR MBI PRAKTIKAT E MIRA

Modele të suksesshme të shërbimeve miqësore për të rinjtë dhe zbatueshmëria e tyre në kontekstin shqiptar

Shtator 2026

Contents

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 5

1.1 Qëllimi 5

1.2 Praktikat e mira 5

1.3 Metodologjia e analizës 5

1.4 Gjetjet kryesore 6

1.5 Kontekstualizimi në Shqipëri 6

1.6 Rekomandimet kryesore 7

2. HYRJE 8

2.1 Konteksti 8

2.2 Metodologjia e analizës 8

2.3 Kriteret për përzgjedhjen e vendeve 9

2.4 Kriteret dhe dimensionet e analizës 10

3. KUADRI KONCEPTUAL PËR SHËRBIMET MIQËSORE PËR TË RINJTË 12

3.1 Shërbime Miqësore për të Rinjtë 12

3.2 Karakteristikat kryesore të Shërbimeve Miqësore për të Rinjtë 12

3.3 Të qenit një praktikë e mirë 13

3.4 Dimensionet e analizës krahasuese në kuadër të shërbimeve miqësore për të rinjtë 14

4. ITALIA 16

4.1 Kuadri institucional dhe qeverisës 16

4.2 Legjislacioni dhe dokumentet strategjike 18

4.3 Qendra të Agregimit Rinor 19

4.4 Karakteristikat kryesore të modelit 20

4.5 Faktorët që kontribuojnë në funksionimin e modelit 20

5. GJERMANIA 22

5.1 Kuadri institucional dhe qeverisës 22

5.2 Sistemi i shërbimeve për të rinjtë - Jugendhilfe 24

5.3 Legjislacioni dhe dokumentet strategjike 25

5.4 Karakteristikat kryesore të modelit 26

5.5 Faktorët që kontribuojnë në funksionimin e modelit 26
6. GREQIA 28
6.1 Kuadri institucional dhe qeverisës 28
6.2 Legjislacioni dhe dokumentet strategjike 30
6.3 Modeli i Shërbimeve Miqësore për të Rinjtë: Njësitë e Shëndetit për Adoleshentët 31
6.4 Karakteristikat kryesore të modelit 32
6.5 Faktorët që kontribuojnë në funksionimin e modelit 32
7. ANALIZË KRAHASUESE E MODELEVE DHE PRAKTIKAVE 34
7.1 Analizë krahasuese e kuadrit institucional dhe organizues 34
7.2 Analizë krahasuese e standardeve të ofrimit të shërbimeve 35
7.3 Përmbledhje krahasuese 36
7.4 Faktorët e përbashkët që kontribuojnë në funksionimin e modeleve 37
7.4.1. Faktorët e përbashkët të suksesit 37
7.5 Dallimet kryesore 38
8. PËRSHTATJA ME KONTEKSTIN E SHQIPËRISË 41
8.1 Konteksti aktual shqiptar 41
8.2 Legjislacioni dhe dokumentet strategjike 43
8.3 Karakteristikat kryesore të sistemit aktual 45
8.4.1 Qasja e përshtatjes për Shqipërinë 46
8.4.2 Përfundimi i vlerësimit 47
9. REKOMANDIME PËR KONTEKSTUALIZIMIN NË SHQIPËRI 48
10. Përmbledhja e rekomandimeve 52
Aneksi nr. 1 – "Matrica e përshtatjes së praktikave ndërkombëtare për Shqipërinë" ... 54

Lista e shkurtimeve:

Raport – “Raporti kërkimor mbi praktikat e mira, Modele të suksesshme të Shërbimeve Miqësore për të Rinjtë dhe zbatueshmëria e tyre në kontekstin shqiptar”;

ShMR - Shërbimet miqësore për të rinjtë;

QAR - Qendrat e Agregimit Rinor;

NjShA – Njësitë e Shëndetit për Adoleshentët;

BE - Bashkimi Evropian;

FKPP - Fondi Kombëtar për Politikat Rinore;

AKR - Agjencia Kombëtare e Rinisë;

KKR - Këshilli Kombëtar i Rinisë;

KVR - Këshillat Vendor të Rinisë.

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Qëllimi

“Raporti kërkimor mbi praktikat e mira, Modele të suksesshme të Shërbimeve Miqësore për të Rinjtë dhe zbatueshmëria e tyre në kontekstin shqiptar” (Raport), shqyrton mënyrën se si shërbimet për të rinjtë organizohen dhe funksionojnë në Itali, Gjermani dhe Greqi. Analiza është përqendruar jo vetëm te shërbimet, por edhe te kushtet që i bëjnë ato funksionale: kuadri institucional dhe ligjor, mënyra e planifikimit dhe financimit, roli i vetëqeverisjes vendor, kapacitetet e ofruesve, koordinimi dhe referimi, pjesëmarrja e të rinjve dhe mekanizmat e monitorimit.

Qëllimi i raportit nuk është identifikimi i një modeli të vetëm për t’u kopjuar në Shqipëri. Vlera e analizës krahasuese qëndron në evidentimin e elementeve që mund të integrohen në sistemin ekzistues shqiptar, duke marrë në konsideratë kuadrin ligjor dhe institucional, kapacitetet e institucioneve dhe ofruesve, burimet financiare dhe dallimet territoriale. Në këtë kuptim, raporti shërben si bazë analitike për zhvillimin e një qasjeje shqiptare ndaj shërbimeve miqësore për të rinjtë (ShMR) dhe për përcaktimin e elementeve që mund të përfshihen në standarde, modele ofrimi, mekanizma koordinimi dhe instrumente monitorimi.

1.2 Praktikat e mira

Përzgjedhja e Italisë, Gjermanisë dhe Greqisë ka mundësuar krahasimin e tre përvojave të ndryshme në organizimin dhe ofrimin e shërbimeve për të rinjtë. Italia është shqyrtuar për përvojën e saj me shërbimet rinore komunitare dhe territoriale, veçanërisht përmes Qendrave të Agregimit Rinor (QAR). Gjermania është analizuar përmes sistemit të Jugendhilfe dhe punës së hapur rinore, me vëmendje te roli i vetëqeverisjes vendore, koordinimi dhe përfshirja. Për Greqinë është analizuar modeli i Njësive të Shëndetit për Adoleshentët (NjShA), i cili ndërthur parandalimin, këshillimin dhe mbështetjen psikosociale.

Këto raste nuk janë trajtuar si modele të gatshme për t’u transferuar. Ato janë përdorur për të kuptuar se cilët përbërës të një shërbimi e bëjnë atë më të aksesueshëm, më të përshtatshëm dhe më të orientuar drejt të rinjve dhe cilat prej këtyre elementeve varen nga mënyra e organizimit të sistemit në secilin vend.

1.3 Metodologjia e analizës

Analiza është mbështetur kryesisht në kërkim dokumentar dhe shqyrtimin e burimeve institucionale, ligjore dhe profesionale. Për secilin vend janë analizuar kuadri ligjor dhe strategjik, politikat rinore, organizimi i shërbimeve, standardet e ofrimit, roli i vetëqeverisjes vendore dhe i organizatave të shoqërisë civile, mekanizmat e pjesëmarrjes, financimi, koordinimi, monitorimi dhe qëndrueshmëria.

Një element i rëndësishëm i metodologjisë është analiza në tre nivele: përdoruesi, ofrimi dhe sistemi. Kjo qasje mundëson lidhjen e dy aspekteve që shpesh trajtohen veçmas: përvojën konkrete të të riut gjatë përdorimit të shërbimit dhe mënyrën se si institucionet, ofruesit dhe mekanizmat e koordinimit krijojnë kushtet për atë përvojë.

Krahasimi është përdorur për të dalluar jo vetëm ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet vendeve, por edhe elementet që kanë potencial të përshtaten në Shqipëri. Në këtë proces është marr në konsideratë se një praktikë funksionale në një vend nuk mund të transferohet pa ndryshime, nëse kushtet institucionale, financiare ose territoriale janë të ndryshme.

1.4 Gjetjet kryesore

Analiza tregon se, pavarësisht ndryshimeve ndërmjet tre vendeve, ShMR mbështeten në disa elemente të përbashkëta. Të rinjtë duhet të jenë në gjendje ta gjejnë dhe ta kuptojnë informacionin, të kenë akses real në shërbim dhe të marrin mbështetjen që i përgjigjet nevojës së tyre. Për këtë kërkohet jo vetëm një shërbim i disponueshëm, por edhe komunikim i përshtatshëm, pika të qarta kontakti, orientim dhe referim, koordinim ndërmjet ofruesve dhe mundësi për të shprehur mendimin dhe për të ndikuar në përmirësimin e shërbimit.

Tre modelet sjellin mësime të ndryshme. Përvoja italiane tregon rëndësinë e afërsisë me komunitetin dhe të hapësirave që shërbejnë njëkohësisht për informacion, orientim, aktivitete dhe mbështetje. Përvoja gjermane nxjerr në pah rëndësinë e planifikimit dhe përgjegjësisë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, si dhe të lidhjes ndërmjet shërbimeve brenda një sistemi të koordinuar. Përvoja greke tregon vlerën e qasjes multidisiplinare dhe të lidhjes ndërmjet parandalimit, identifikimit të nevojave dhe mbështetjes së mëtejshme.

Një përfundim i rëndësishëm për Shqipërinë është se zhvillimi i ShMR nuk kërkon domosdoshmërisht krijimin e një sistemi të ri shërbimesh për të rinjtë. Më e përshtatshme është që perspektiva e të rinjve të integrohet gradualisht në shërbimet ekzistuese dhe në shërbimet e reja, duke përmirësuar mënyrën se si ato planifikohen, komunikohen, aksesohen, ofrohen dhe monitorohen.

1.5 Kontekstualizimi në Shqipëri

Nga analiza krahasuese rezulton se procesi i kontekstualizimit në Shqipëri duhet të nisë nga sistemi ekzistues dhe jo nga krijimi i strukturave paralele. Pesë dimensionet e propozuara për ShMR mund të përdoren si pikënisje për të shqyrtuar se ku funksionojnë shërbimet aktuale dhe ku krijohen pengesa për të rinjtë.

Në këtë qasje, rëndësi të veçantë kanë shërbimet dhe pikat ekzistuese në nivelin e vetëqeverisjes vendore, mekanizmat e koordinimit dhe referimit, komunikimi i kuptueshëm, përdorimi i kanaleve digjitale dhe komunitare dhe përfshirja e të rinjve në identifikimin e nevojave dhe vlerësimin e

shërbimeve. Zbatimi duhet të shoqërohet me monitorim të rezultateve dhe me përdorimin sistematik të mendimeve të të rinjve për të përcaktuar ndryshimet e nevojshme.

1.6 Rekomandimet kryesore

Në vijim të gjetjeve të Raportit, rekomandohet që zhvillimi i ShMR në Shqipëri të mbështetet në një proces gradual dhe të integruar. Hapat kryesorë përfshijnë:

- **Hartëzimin dhe vlerësimin e shërbimeve ekzistuese**, duke përdorur pesë dimensionet e ShMR dhe duke identifikuar pengesat që hasin të rinjtë.
- **Përcaktimin e një kuadri të përbashkët parimesh dhe standardesh**, që mund të përdoret nga ofruesit e shërbimeve në sektorë dhe nivele të ndryshme.
- **Identifikimin e shërbimeve prioritare për përshtatje**, bazuar në nevojat e të rinjve, pengesat e aksesit dhe rëndësinë e shërbimit.
- **Përmirësimin e mënyrës së ofrimit**, veçanërisht informacionit, procedurave, orareve, kanaleve të aksesit, orientimit dhe referimit.
- **Forcimin e koordinimit ndërmjet nivelit qendror, vendor dhe ofruesve**, duke përdorur mekanizma ekzistues dhe duke përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë.
- **Krijimin ose përshtatjen e pikave të aksesit dhe orientimit**, duke përdorur strukturat dhe hapësirat ekzistuese dhe duke i lidhur ato me rrjetin e shërbimeve.
- **Përfshirjen e të rinjve në mënyrë të strukturuar**, nga identifikimi i nevojave deri te monitorimi dhe përmirësimi i shërbimeve.
- **Testimin e elementeve të përshtatura**, në disa fusha dhe shërbime prioritare, përpara zgjerimit të tyre në shkallë më të gjerë.
- **Krijimin e një sistemi të përbashkët monitorimi dhe vlerësimi**, që mat jo vetëm aktivitetet dhe numrin e përdoruesve, por edhe aksesin, përvojën e të rinjve, rezultatet dhe ndryshimet e arritura.
- **Integrimin gradual të ShMR në planifikimin dhe financimin publik**, në mënyrë që praktikat e suksesshme të mos mbeten të varura vetëm nga projektet dhe financimet e përkohshme.

2. HYRJE

2.1 Konteksti

Zhvillimi i ShMR lidhet me nevojën për shërbime më të aksesueshme, gjithëpërfshirëse, të përshtatura dhe cilësore, të cilat u përgjigjen nevojave dhe rrethanave të ndryshme të të rinjve. Qasja ndaj ShMR nuk kufizohet vetëm te krijimi i shërbimeve të dedikuara për të rinjtë por ajo përfshin edhe përshtatjen e shërbimeve ekzistuese, në mënyrë që ato të jenë më të kuptueshme, më të arritshme dhe më të përshtatura për përdoruesit e rinj.

Në Shqipëri, zhvillimi i politikave rinore dhe forcimi i mekanizmave institucionalë për mbështetjen e të rinjve kanë krijuar një bazë të rëndësishme për përmirësimin e shërbimeve. Megjithatë, kalimi nga kuadri i politikave dhe strategjive te shërbimet konkrete kërkon modele, standarde dhe mekanizma të qartë për planifikimin, organizimin, ofrimin, koordinimin, pjesëmarrjen e të rinjve dhe monitorimin e tyre. Studimi i praktikave të mira ndërkombëtare krijon mundësi për të kuptuar se si këto elemente janë organizuar në kontekste të ndryshme dhe cilat prej tyre mund të jenë me interes për Shqipërinë.

Kërkimi për praktikat ndërkombëtare nuk synon identifikimin e një modeli që mund të kopjohet ose të zbatohet drejtpërdrejt në Shqipëri. Fokusi është te parimet, mekanizmat dhe praktikat që mund të përshtaten me kuadrin institucional, ligjor, territorial dhe shoqëror shqiptar. Për këtë arsye, analiza nuk shqyrton vetëm llojin e shërbimeve të ofruara, por edhe mënyrën se si ato planifikohen, organizohen, financohen, koordinohen, ofrohen dhe përmirësohen në përgjigje të nevojave dhe rrethanave të të rinjve.

2.2 Metodologjia e analizës

Raporti mbështetet në një qasje krahasuese dhe funksionale, e cila shqyrton mënyrën se si organizohen dhe funksionojnë ShMR në tre vendet e përzgjedhura. Analiza nuk kufizohet në përshkrimin e shërbimeve, por merr në konsideratë edhe kushtet që mundësojnë funksionimin e tyre: kuadrin institucional dhe ligjor, planifikimin, financimin, kapacitetet e ofruesve, koordinimin, pjesëmarrjen e të rinjve dhe mekanizmat e monitorimit e të përmirësimit.

Kërkimi është mbështetur kryesisht në analizën dokumentare dhe në rishikimin e burimeve institucionale dhe profesionale. Këtu përfshihen legjislacioni dhe dokumentet strategjike, dokumentet e politikave publike, udhëzimet dhe standardet për shërbimet, dokumentet e institucioneve përgjegjëse, materialet e organizatave ndërkombëtare, dokumentet dhe standardet përkatëse të Bashkimit Evropian (BE), si dhe informacioni i disponueshëm mbi ofruesit dhe modelet konkrete të shërbimeve.

Burimet janë shqyrtuar jo vetëm për të evidentuar ekzistencën formale të politikave, standardeve dhe mekanizmave, por edhe për të kuptuar se si ato përkthehen në struktura, procedura dhe mënyra konkrete të ofrimit të shërbimeve për të rinjtë.

Për secilin vend është përzgjedhur një model ose praktikë konkrete, mbi bazën e rëndësisë së saj për parimet e ShMR dhe të mësimeve që mund të ofrojë për kontekstin shqiptar. Përzgjedhja nuk synon të përfaqësojë të gjithë sistemin e shërbimeve rinore të secilit vend. Ajo fokusohet në elemente të caktuara që ndihmojnë në kuptimin e mënyrës se si një shërbim mund të bëhet më i aksesueshëm, gjithëpërfshirës, cilësor, i përshtatur dhe pjesëmarrës. Analiza është organizuar në tre nivele të ndërlidhura:

- **Niveli i përdoruesit**, ku shqyrtohen përvoja e të riut, qasshmëria dhe mënyra se si shërbimi përjetohet dhe përdoret;
- **Niveli i ofrimit**, ku analizohen organizimi, kapacitetet, proceset dhe mënyra e ofrimit të shërbimit;
- **Niveli i sistemit**, ku shqyrtohen politikat, institucionet, financimi, koordinimi dhe mekanizmat e monitorimit.

Kjo strukturë ndihmon në lidhjen e dy niveleve të analizës që shpesh trajtohen veçmas: mënyrës se si funksionon sistemi dhe përvojës konkrete të të riut në përdorimin e shërbimit.

Për secilin model është shqyrtuar gjithashtu se çfarë funksionon, në çfarë kushtesh funksionon, cilat janë parakushtet institucionale, organizative dhe financiare dhe cilat elemente mund të përshtaten në Shqipëri. Kjo qasje mundëson dallimin ndërmjet praktikave të lidhura ngushtë me kontekstin e vendit dhe parimeve ose mekanizmave që mund të kenë vlerë edhe në një kontekst tjetër. Gjetjet e analizës përdoren për të evidentuar faktorët e përbashkët të identifikuar në modelet e shqyrtuara, dallimet kryesore dhe elementet me potencial për t'u përshtatur në Shqipëri.

2.3 Kriteret për përzgjedhjen e vendeve

Për analizën e praktikave të mira janë përzgjedhur Italia, Gjermania dhe Greqia. Përzgjedhja është bërë duke marrë në konsideratë ndryshimet në modelet e tyre institucionale dhe të organizimit të shërbimeve, por edhe elementet që mund të jenë me interes për zhvillimin e ShMR në Shqipëri:

- **Italia** – Italia është përfshirë në analizë për shkak të afërsisë historike, kulturore dhe gjeografike me Shqipërinë, si dhe të disa ngjashmërive në organizimin territorial dhe ofrimin e shërbimeve publike. Përvoja italiane ofron shembuj të integrimit të nevojave të të rinjve në shërbime dhe hapësira të organizuara në nivel komunitar dhe territorial. Praktika e përzgjedhur është modeli i shërbimit rinor komunitar dhe territorial, i ilustruar përmes QAR[1] me fokus te aksesi, shoqërimi, zhvillimi personal, aktivitetet socio-edukative dhe lidhja me komunitetin.
- **Gjermania** – është një partner dhe destinacion i madh ekonomik për emigrantët shqiptarë, duke ofruar një model të fuqishëm të shërbimeve të decentralizuara për të rinjtë dhe një fokus të fortë në përfshirjen e grupeve vulnerabël. Gjermania është përfshirë për shkak të përvojës së konsoliduar në organizimin e shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë përmes një

[1] Centri di Aggregazione Giovanile – CAG.

sistemi të decentralizuar dhe të koordinuar në nivel vendor. Roli i bashkive në planifikimin, financimin dhe ofrimin e shërbimeve, së bashku me fokusin te përfshirja e të rinjve që përballen me pengesa sociale, ekonomike ose të tjera, e bën këtë model të rëndësishëm për analizën krahasuese. Praktika e përzgjedhur është përvoja e Jugendhilfe[2] dhe e punës së hapur rinore, e cila mundëson shqyrtimin e mënyrës se si përgjegjësitë kombëtare dhe lokale, shërbimet dhe aktorët e ndryshëm ndërthuren në mbështetje të të rinjve.

- **Greqia** – është përfshirë për shkak të afërsisë së drejtpërdrejtë gjeografike me Shqipërinë dhe lidhjeve historike, kulturore dhe ekonomike ndërmjet dy vendeve. Përvoja greke është me interes të veçantë për analizën e shërbimeve të orientuara drejt nevojave të të rinjve në fushën e shëndetit, mirëqenies psikosociale dhe integrimit social. Praktika e përzgjedhur është modeli i NjShA[3], i kombinuar me ndërhyrje në komunitet dhe në shkolla dhe me mbështetjen e organizatave sociale. Ky model ofron një shembull të integrimit të parandalimit, këshillimit, edukimit dhe mbështetjes psikosociale përmes qasjeve multidisiplinare dhe të orientuara drejt nevojave të përdoruesve.

2.4 Kriteret dhe dimensionet e analizës

Për të siguruar një analizë të strukturuar dhe të krahasueshme, për secilin model është përdorur një kornizë e përbashkët analitike. Kjo kornizë shqyrton si mënyrën e organizimit të shërbimit, ashtu edhe kushtet institucionale dhe praktike që ndikojnë në funksionimin e tij.

Dimensioni i analizës	Çfarë shqyrtohet
Kuadri ligjor dhe institucional	Legjislacioni, institucionet përgjegjëse, ndarja e kompetencave dhe mekanizmat e koordinimit.
Politikat rinore	Objektivat, prioritetet dhe qasja ndaj nevojave të të rinjve.
Sistemi i shërbimeve	Llojet e shërbimeve, mënyra e organizimit, grupet e synuara dhe mënyrat e aksesimit.
Standardet e shërbimeve	Qasshmëria, gjithëpërfshirja, cilësia, përshtatshmëria, siguria, privatësia, pjesëmarrja, shtrirja, monitorimi dhe vlerësimi, marrja e mendimeve.
Roli i pushtetit vendor	Planifikimi, financimi, ofrimi, koordinimi dhe monitorimi në nivel vendor.
Roli i shoqërisë civile	Ofrimi i shërbimeve, ndërmjetësimi, inovacioni, mbështetja e grupeve vulnerabël dhe angazhimi komunitar.
Pjesëmarrja e të rinjve	Konsultimi, bashkëkrijimi, mekanizmat e marrjes së mendimeve dhe përfshirja në vendimmarrje.
Mekanizmat e financimit	Burimet e financimit, financimi publik, bashkëfinancimi dhe financimi i ofruesve.

[2] Jugendhilfe.
[3] Njësitë e Shëndetit për Adoleshentët.

Koordinimi dhe partneritetet	Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërmjet sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile.
Monitorimi dhe vlerësimi	Treguesit, mbledhja e mendimeve dhe matja e rezultateve dhe mekanizmat e përmirësimit.
Qëndrueshmëria	Kapacitetet institucionale, financiare dhe njerëzore dhe mundësia e vazhdimit të modelit pas përfundimit të financimit fillestar.

Përtej këtyre dimensioneve, për secilin model janë shqyrtuar faktorët që mbështesin funksionimin e tij, rëndësia për Shqipërinë, potenciali për transferim dhe përshtatjet që mund të kërkohen. Në këtë mënyrë, analiza synon të dallojë ndërmjet praktikave që mund të përshtaten me ndryshime të kufizuara dhe atyre që kërkojnë ndryshime më të thella ligjore, institucionale, organizative, financiare ose në kapacitete.

3. KUADRI KONCEPTUAL PËR SHËRBIMET MIQËSORE PËR TË RINJTË

3.1 Shërbime Miqësore për të Rinjtë

Në kuadër të këtij Raporti, ShMR kuptohen si shërbime publike ose të ofruara nga ofrues të tjerë, të organizuara dhe të përshtatura në mënyrë që t'u përgjigjen nevojave, karakteristikave dhe rrethanave të ndryshme të të rinjve.

Një ShMR mund të jetë një shërbim i krijuar posaçërisht për të rinjtë ose një shërbim ekzistues që është përshtatur për t'u bërë më i aksesueshëm, gjithëpërfshirës, i përshtatshëm dhe i sigurt për përdoruesit e rinj. Kjo do të thotë se të qenit ShMR nuk përcaktohet vetëm nga grupi i synuar i shërbimit, por nga mënyra se si ai planifikohet, organizohet, ofrohet dhe përmirësohet.

ShMR u drejtohen të rinjve në diversitetin e tyre, duke marrë në konsideratë moshën, nevojat, rrethanat sociale dhe ekonomike, territorin ku jetojnë dhe pengesat që mund të kufizojnë aksesin dhe përdorimin e shërbimeve. Vëmendje e veçantë i kushtohet të rinjve që përballen me pengesa të shtuara ose rrezik më të lartë për përjashtim nga shërbimet.

3.2 Karakteristikat kryesore të Shërbimeve Miqësore për të Rinjtë

ShMR nuk përcaktohen vetëm nga lloji i shërbimit apo nga fakti që ai u ofrohet të rinjve. Ato dallohen nga mënyra se si shërbimi projektohet, planifikohet, organizohet dhe ofrohet, në mënyrë që të përgjigjet në mënyrë efektive ndaj nevojave të të rinjve dhe të krijojë kushte për akses, përfshirje, pjesëmarrje dhe përdorim të sigurt e cilësor të shërbimit. Prandaj është e rëndësishme analizimi i dimensioneve dhe elementeve të ShMR:

i. **Qasshmëria -** Shërbimet duhet të jenë të arritshme dhe të përdorshme nga të rinjtë, duke reduktuar pengesat që mund të pengojnë marrjen e tyre. Ajo përfshin dimensionet fizike, gjeografike, financiare, informative, digjitale dhe kohore. Kjo nënkupton, ndër të tjera, vendndodhje dhe orare të përshtatshme, kosto të përballueshme, informacion të kuptueshëm dhe kanale të ndryshme aksesi.

ii. **Përshtatshmëria ndaj nevojave të të rinjve -** Një ShMR duhet të marrë në konsideratë moshën, nevojat, interesat, rrethanat dhe diversitetin e të rinjve. Ajo nënkupton që shërbimi nuk ofrohet në mënyrë uniforme, por mund të përshtatet në aspektin e përmbajtjes, komunikimit, procedurave, orareve dhe mënyrës së ofrimit, sipas nevojave të përdoruesve.

iii. **Cilësia dhe siguria -** Shërbimet duhet të ofrohen në mënyrë profesionale, të besueshme dhe të sigurt, duke respektuar të drejtat, dinjitetin dhe privatësinë e të rinjve. Cilësia lidhet me kompetencat e stafit, qartësinë e procedurave, standardet profesionale, sigurinë e përdoruesve dhe orientimin drejt rezultateve dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

iv. **Pjesëmarrja e të rinjve -** Të rinjtë nuk konsiderohen vetëm si përfitues të shërbimeve, por edhe si aktorë në zhvillimin dhe përmirësimin e tyre. Pjesëmarrja mund të realizohet përmes konsultimit, bashkëhartimit, përfshirjes në zbatim, vlerësimit të shërbimeve dhe mekanizmave të tjerë që u japin të rinjve mundësi të ndikojnë në vendimmarrje.

v. **Përfshirja dhe qasja ndaj të rinjve që përballen me pengesa -** ShMR duhet të marrin në konsideratë diversitetin e të rinjve dhe të identifikojnë pengesat që mund të çojnë në përjashtim ose pabarazi në akses. Qasja nënkupton vëmendje të veçantë ndaj të rinjve që përballen me pengesa sociale, ekonomike, territoriale, fizike, digjitale ose të tjera, duke synuar që shërbimet të jenë të aksesueshme edhe për grupet që rrezikojnë të mbeten jashtë tyre.

vi. **Informacioni dhe komunikimi -** Informacioni duhet të jetë i kuptueshëm, i përditësuar dhe i disponueshëm përmes kanaleve të përshtatshme për të rinjtë, duke përdorur gjuhë të qartë dhe forma të ndryshme komunikimi.

vii. **Koordinimi dhe referimi -** ShMR duhet të funksionojnë në lidhje me shërbime dhe aktorë të tjerë, përmes mekanizmave të koordinimit dhe referimit. Kjo ndihmon në shmangien e fragmentimit të shërbimeve dhe në sigurimin e një përgjigjeje më të integruar dhe të vazhdueshme ndaj nevojave të të rinjve.

viii. **Digjitalizimi -** Teknologjia dhe kanalet digjitale mund të përmirësojnë aksesin, informacionin, komunikimin dhe ofrimin e shërbimeve. Një ShMR duhet të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të mjeteve digjitale në mënyrë të përshtatshme për të rinjtë, duke marrë njëkohësisht në konsideratë aksesin e barabartë, aftësitë digjitale, privatësinë dhe sigurinë e informacionit.

ix. **Marrja e mendimeve dhe përmirësimi i vazhdueshëm -** Mendimet dhe përvoja e të rinjve duhet të përdoren për të kuptuar nëse shërbimi po i përgjigjet nevojave të tyre dhe ku nevojiten ndryshime. Mekanizmat e marrjes së mendimit, monitorimit dhe vlerësimit duhet të lidhen me procese konkrete për përmirësimin e shërbimit. Në këtë mënyrë, ShMR trajtohet si një proces dinamik që përshtatet në bazë të evidencës dhe përvojës së përdoruesve.

Këto karakteristika përbëjnë bazën e përbashkët të analizës së praktikave të përzgjedhura në Itali, Gjermani dhe Greqi. Ato nuk trajtohen si kritere të izoluara, por si elemente të ndërlidhura që ndikojnë në përvojën e të riut, në mënyrën e ofrimit të shërbimit dhe në funksionimin e sistemit që e mbështet atë.

3.3 Të qenit një praktikë e mirë

Në kuadër të këtij Raporti, një praktikë konsiderohet e mirë kur disponohet evidencë e mjaftueshme për mënyrën e organizimit dhe zbatimit të saj dhe kur ajo paraqet elemente që mund të ofrojnë mësime të vlefshme për zhvillimin e ShMR. Vlerësimi i praktikës merr në konsideratë disa aspekte:

- **organizimin institucional** – rolet, përgjegjësitë, kapacitetet dhe mekanizmat që e mbështesin;
- **zbatimin** – mënyra se si praktika funksionon në institucion, shërbim ose territor;
- **rezultatet dhe përvojën e përdoruesve** – evidenca mbi përdorimin, rezultatet ose përvojën e të rinjve, aty ku kjo evidencë është e disponueshme;

- **koordinimin dhe qëndrueshmërinë** – mënyra se si praktika lidhet me aktorë të tjerë dhe kushtet për vazhdimësinë e saj;
- **rëndësinë për Shqipërinë** – elementet që mund të ofrojnë mësime për kuadrin institucional dhe mënyrën e organizimit të shërbimeve në Shqipëri.

Termi "Praktikë e mirë" në këtë Raport nuk përdoret për të nënkuptuar se modeli i përzgjedhur është domosdoshmërisht më i mirë se alternativat e tjera. Ai i referohet praktikave që, mbi bazën e informacionit dhe evidencës së disponueshme, paraqesin elemente të vlefshme për t'u analizuar dhe për të nxjerrë mësime. Për secilin nga vendet e përzgjedhura është identifikuar një model ose praktikë konkrete, e cila është shqyrtuar në lidhje me karakteristikat e ShMR, mënyrën e organizimit dhe ofrimit, kontekstin në të cilin është zhvilluar dhe mundësinë e përshtatjes së disa prej elementeve të saj në Shqipëri.

3.4 Dimensionet e analizës krahasuese në kuadër të shërbimeve miqësore për të rinjtë

Për të siguruar një analizë krahasuese të modeleve të përzgjedhura në Itali, Gjermani dhe Greqi, analiza është mbështetur në një kornizë të përbashkët krahasimi. Kjo kornizë lidh përvojën e përdoruesit me mënyrën e ofrimit të shërbimit dhe me kushtet institucionale që i mbështesin.




Figura nr. 1 Dimensionet e Analizës Krahasuese

4. ITALIA

Modeli italian i politikave dhe shërbimeve për të rinjtë karakterizohet nga një organizim shumë-nivelesh, ku përgjegjësitë dhe instrumentet e politikës rinore shpërndahen ndërmjet nivelit kombëtar, Rajoneve, Provincave autonome dhe autoriteteve vendore. Në këtë model, niveli kombëtar përcakton drejtimet dhe prioritetet e përgjithshme, ndërsa niveli territorial ka përgjegjësi për përshtatjen e ndërhyrjeve sipas karakteristikave dhe nevojave lokale.

Italia nuk paraqet një katalog të vetëm kombëtar të shërbimeve rinore me të njëjtat forma organizimi në të gjithë territorin. Përkundrazi, shërbimet janë zhvilluar nëpërmjet një rrjeti strukturash publike, private dhe të shoqërisë civile, të cilat funksionojnë në nivele të ndryshme dhe ofrojnë forma të ndryshme informacioni, orientimi, mbështetjeje, edukimi, pjesëmarrjeje dhe socializimi.

4.1 Kuadri institucional dhe qeverisës

Në nivelin kombëtar, përcaktimi i parimeve themelore për fuqizimin e rinisë i përket Parlamentit dhe përgjegjësia për hartimin konkret të tyre i përket Ministrit përgjegjës për rininë. Në varësi të Ministrit funksionon Departamenti për Politika Rinore dhe Shërbimin Civil Universal që përbën strukturën operative të referimit, zbatimit dhe koordinimit të strategjisë për të rinjtë dhe promovimin e të drejtave të të rinjve.


Krah tyre vepron, Agjencia Italiane për Rininë një organ publik, i pajisur me personalitet juridik dhe autonomi rregullatore, organizative, menaxheriale, pasurore, financiare dhe kontabël, që administron programet evropiane dhe zbaton masa për rininë.

Në nivel territorial, rinia organizohet dhe funksionon nëpërmjet Rajoneve dhe Provincave autonome, të cilat mund të hartojnë ligje/dokumente në kuadër rinisë. Me kontributin e Provincave dhe Komunave, Rajonet mund të përcaktojnë kështu nevojat, propozimet, mjetet e mbrojtjes dhe të drejtat, në kuadër të programimit dhe zbatimit të masave për rininë në territoret e tyre përkatës.

Në Itali nuk ekziston një mekanizëm koordinimi ndërministror kushtuar politikave rinore, dhe as një kuadër i qartë juridik apo një angazhim specifik politik që rregullon në mënyrë organike praktikat e bashkëpunimit ndërsektorial në hartimin e politikave për të rinjtë. Megjithatë, brenda Këshillit të Ministrave, për zhvillimin e masave të drejtuara posaçërisht te të rinjtë, Departamenti për Politikat Rinore dhe Shërbimin Civil Universal mbështetet te ndihma e Departamenteve për politikat e: familjes; sportit; personave me aftësi të kufizuara; kohezionit; informacionit dhe botimeve; arsimit, shëndetësisë.

Në nivel kombëtar, Këshilli Kombëtar i Rinisë shërben si një hapësirë për debate dhe shkëmbim eksperiencash midis shoqatave rinore anëtare dhe institucioneve italiane e evropiane, pranë të cilave luan një rol konsultativ dhe propozues në çështjet e politikave rinore. Ai mbështet Këshillat Rajonalë të Rinisë dhe ata që do të krijohen përmes aktiviteteve të konsulencës, trajnimit dhe

Programeve të Ngritjes së Kapaciteteve. Në nivel vendor, funksionojnë Forumet/Këshillat Rajonalë të Rinisë që shërbejnë si një hapësirë takimi, ballafaqimi dhe zhvillimi bashkëpunimesh midis ofruesve të shërbimeve.



Politikat rinore

Hartimi i politikave rinore realizohet përmes përdorimit të njohurive dhe të dhënave empirike. Për sigurimin e tyre janë krijuar institucione publike dhe private si Vëzhguesi Kombëtar për Fëmijërinë dhe Adoleshencën; Qendra Kombëtare e Dokumentacionit dhe Analizës për Fëmijërinë dhe Adoleshencën, Instituti Kombëtar për Analizën e Politikave Publike, Këshilli Kombëtar i Ekonomisë dhe Punës, Këshilli Kombëtar i Kërkimit, Instituti Kombëtar i Statistikave rinore.

Monitorimi dhe vlerësimi i politikave rinore realizohet nëpërmjet: Këshillit Kombëtar të Rinisë, Vëzhgues rajonalë ose territorialë mbi të rinjtë. Duke filluar nga viti 2025 në nivel kombëtar është i detyrueshëm realizimi i Vlerësimit të Ndikimit në Breza, që synon analizën paraprake të akteve normative të Qeverisë – me përjashtim të dekreteve-ligje – me qëllim vlerësimin e efekteve dhe pasojave mjedisore dhe/ose sociale të masave të miratuara mbi të rinjtë dhe brezat e ardhshëm.

Financimi i politikave rinore realizohet përmes Fondit Kombëtar për Politikat Rinore (FKPP) dhe fondeve të BE. FKPP ndahet midis institucioneve në nivel kombëtar, rajoneve dhe provincave nëpërmjet një marrëveshje që miratohet në Konferencën e Përbashkët të organizuar ndërmjet tyre. Rajonet dhe provincat gëzojnë autonomi të plotë në përdorimin e fondeve të miratuara në fushën e rinisë, por përdorimi i tyre i nënshtrohet raportimeve dhe monitorimeve të vazhdueshme në nivel qendror.

Sistemi i shërbimeve për të rinjtë.

Italia nuk ka një model të vetëm, kombëtar të ofrimit të shërbimeve për të rinjtë. Ai është i ngritur në një ekosistem të ndërthurur territorial, ku shërbimi përshtatet me nevojat e të rinjve dhe karakteristikat territoriale të ofrimit të shërbimit. Sistemi i ofrimit të shërbimeve është një sistem që ka shërbime të integruara që ofrohen nëpërmjet ofruesve publikë dhe privatë të shërbimeve:

- **Informagiovanni -** Informacion dhe orientim për arsim, trajnim, punë, kohë të lirë dhe mundësi.
- **Qendrat e Agregimit për të Rinjtë** – janë qendra të ofrimit shërbimeve rekreative dhe edukative për kohën e lirë, me synimin për të vlerësuar pjesëmarrjen e të miturve në nivel propozues, vendimmarrës dhe menaxhuese, si dhe ndërveprime mbi çështje të rëndësishme për bashkëjetesën civile dhe zhvillimin e aftësive të shoqërimit dhe të përfshirjes në shkollë, në jetën shoqërore dhe familjare.
- **Youthwork -** Mbështetje edukative, zhvillim personal e social, pjesëmarrje dhe autonomi.
- **Grupe edukative mbështetëse** – janë grupe që përfshijnë djem dhe vajza më në rrezik, me qëllim shoqërimin dhe ndihmën në studime.
- **Animacioni socio-edukativ në rrugë, -** aktivitet i drejtuar ndaj grupeve të adoleshentëve dhe të rinjve në vendet e takimit, që synon të parandalojë faktorët e rrezikut.
- **Animacioni socio-edukativ në ambient të hapur -** edukimi në natyrë i realizuar në Qendra Verore dhe vende të shenjta/Qendra pushimi.
- **Shërbimi Civil për Adoleshentët -** një eksperiencë edukative për të rinjtë e bazuar në përfshirjen në aktivitete vullnetare, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat dhe zyrën shkollore rajonale.
- **Qendrat e Informimit për Adoleshentë** - si një shërbim informativ i orientuar drejt nevojave dhe interesave të adoleshentëve brenda zyrave të "Informagiovani".
- **Veprimtari të tjera të animacionit socio-edukativ në fushën e adoleshencës në nivel rajonal -** Lojëra/laboratorë, Qendra grumbullimi/sociale; Qendra ditore verore; Qendra me funksion socio-mbështetës; Qendra ditore me funksion mbrojtjeje sociale.

Sistemi i shërbimeve është organizuar si një sistem i ndërlidhur nyjash, ku Informagiovani është nyja e parë hyrëse në sistem për të vijuar më pas me rrjetin e shërbimeve.

4.2 Legjislacioni dhe dokumentet strategjike


Legjislacioni në fushën e rinisë përbëhet nga ligji kombëtar për rininë – legjislacion i përbashkët midis shtetit, Rajoneve dhe Provincave autonome. Rajonet miratojnë legjislacionin e tyre në kuadër të rinisë, ku 18 nga 20 Rajonet italiane kanë miratuar legjislacionin e tyre në këtë fushë.

Legjislacioni në fushën e rinisë arrin të zbatohet nëpërmjet Strategjisë kombëtare për të rinjtë që miratohet nga mekanizimi i koordinimit ndërinstitucional, Konferenca e Përbashkët. Realizimi i politikave rinore dhe objektivave të përcaktuar në Strategji, detyron Rajonet që të hartojnë plane trevjeçare për zbatimin e saj.

Standardet për shërbimet

Në Itali, standardizimi i shërbimeve rinore përshtatet me organizimin territorial, pra nuk ekziston një paketë e unifikuar kombëtare e standardeve për ShMR. Standardet dhe kërkesat konkrete përcaktohen kryesisht në nivel rajonal dhe vendor, ndërsa në nivel kombëtar zhvillohet një kuadër

i përgjithshëm për politikat rinore dhe youth work. Megjithatë, në modelet territoriale të analizuara përsëriten disa standarde funksionale:



4.3 Qendra të Agregimit Rinor

QAR[4] mund të përkufizohet si një njësi shërbimi e drejtuar te të rinjtë dhe fëmijët/adoleshentët. Organizimi i saj nuk gjendet në një ligj specifik në nivel kombëtar, por rregullohet nga legjislacionet rajonale, të cilat lejojnë një fleksibilitet të dukshëm në ngritjen dhe menaxhimin e shërbimit, por nuk favorizojnë një ofertë homogjene shërbimesh në të gjithë territorin kombëtar. QAR nuk kuptohet si një shërbim i specializuar në një problematikë të caktuar dhe i drejtuar një përdoruesi të paracaktuar, por si një vend takimi ku, me ndihmën e operatorëve të trajnuar, njeriu njeh veten dhe të tjerët brenda një mjedisi të mbrojtur dhe me aktivitete krijuese.

Lindja e QAR ndodhi rreth viteve tetëdhjetë, kur komuniteti kuptoi krizën që përfshin agjencitë edukative tradicionale, si shkolla dhe institucionet fetare, dhe mori përsipër "çështjen rinore", duke modifikuar dhe zgjeruar strukturat tashmë të pranishme në territor. QAR janë të organizuar në tre nivele menaxhimi: vendor; privat me marrëveshje me institucionet vendore; nga institucionet fetare, por laike në aspektin e ofrimit të shërbimit.

Organizimi i shërbimit duket shumë i larmishëm dhe ndryshon nga qendra në qendër për orarin e hapjes, përdoruesve të cilit i drejtohet, praninë sasiore dhe cilësore të të rinjve, por mbi të gjitha për propozimet edukative të realizuara. Ka QAR të fokusuara në një problematikë të vetme ose në një lloj të caktuar përdoruesish dhe QAR që përfshijnë laboratorë aktivitetesh dhe momente joformale; QAR që përfshijnë kategori të ndryshme përdoruesish të rinj të moshës së para adoleshencës dhe të rinj n ë moshë madhore.

[4] Centro di Aggregazione Giovanile Torino

Kapacitete administrative të QAR janë padyshim edukatorët dhe animatorët, megjithëse analiza e situatave dhe projektimi i ndërhyrjeve kërkojnë një punë në ekip dhe një bashkëpunim të ngushtë me operatorët e tjerë. Aspekti pedagogjik luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e shërbimit dhe ka nevojë për shërbimin psikologjik dhe sociologjik mbi komunikimin dhe mbi grupet e bashkëmoshatarëve për të arritur një vizion unitar të të rinjve me të cilët ndërveprohet. Një nga funksionet që e karakterizon më shumë punën në QAR është që ajo është një urë që lidh botën rinore me atë më të rritur, duke ruajtur megjithatë një gjuhë dhe një stil të vetin të të rinjve. QAR mbetet një territor ekskluziv i të rinjve, një lloj "hapësire e mbrojtur", ku të mund të ndërtojnë marrëdhëniet e tyre duke u ballafaquar me botën e jashtme dhe nga e cila dalin gradualisht.

4.4 Karakteristikat kryesore të modelit



4.5 Faktorët që kontribuojnë në funksionimin e modelit

- ✓ **Mbështetja institucionale -** Përfshirja e bashkive dhe autoriteteve të tjera publike krijon bazën institucionale për planifikimin, financimin dhe integrimin e QAR në politikat dhe shërbimet territoriale. Mbështetja publike ndihmon gjithashtu në krijimin e lidhjeve me shkollat, shërbimet sociale dhe aktorët e tjerë lokalë.
- ✓ **Projektimi i orientuar nga përdoruesi -** Aktivitetet dhe mënyra e funksionimit përshtaten me interesat dhe nevojat e të rinjve të territorit. Hapësira e hapur dhe fleksibiliteti i aktiviteteve mundësojnë që qendra të reagojë ndaj kërkesës të të rinjve.
- ✓ **Staf i trajnuar -** Stafi socio-edukativ është thelbësor për krijimin e marrëdhënieve të besimit me të rinjtë, lehtësimin e aktiviteteve, identifikimin e nevojave dhe orientimin drejt shërbimeve të tjera.
- ✓ **Koordinimi -** Lidhja ndërmjet QAR, bashkive, shkollave, organizatave të shoqërisë civile dhe shërbimeve të tjera krijon një qasje më të integruar. Koordinimi redukton izolimin e qendrës dhe e kthen atë në një nyje brenda ekosistemit lokal të shërbimeve rinore.

- ✓ **Mjetet digjitale -** Kanalet digjitale zgjerojnë mënyrat përmes të cilave të rinjtë informohen, komunikojnë dhe angazhohen me qendrën. Ato mund të plotësojnë, por jo të zëvendësojnë, aksesin fizik dhe kontaktin e drejtpërdrejtë me stafin.
- ✓ **Pjesëmarrja e të rinjve -** Përfshirja e të rinjve në identifikimin e nevojave, hartimin e aktiviteteve dhe marrjen e mendimit rrit përshtatshmërinë e shërbimit. Pjesëmarrja krijon gjithashtu mundësi që të rinjtë të marrin rol aktiv në jetën dhe zhvillimin e qendrës.
- ✓ **Financimi i qëndrueshëm -** Financimi i parashikueshëm është i rëndësishëm për vazhdimësinë e stafit, aktiviteteve, mirëmbajtjes së hapësirës dhe planifikimit afatmesëm. Kombinimi i mbështetjes publike me burime të tjera mund të rrisë kapacitetin për të ruajtur dhe zhvilluar shërbimin.
- ✓ **Monitorimi dhe marrja e mendimeve** - Mbledhja sistematike e të dhënave mbi përdorimin e shërbimit, pjesëmarrjen dhe përvojën e të rinjve ndihmon në identifikimin e problemeve dhe përshtatjen e aktiviteteve. Marrja e mendimeve e lidh monitorimin me përmirësimin konkret të shërbimit.

5. GJERMANIA

5.1 Kuadri institucional dhe qeverisës

Në Gjermani, kuadri kryesor për shërbimet ndaj fëmijëve dhe të rinjve është SGB VIII – Kinder- und Jugendhilfe. Ligji përcakton se Jugendhilfe synon zhvillimin individual dhe social të të rinjve, reduktimin e disavantazheve dhe mundësimin e pjesëmarrjes së barabartë në shoqëri.

Në nivel federal, qeveria (Bund) përcakton kuadrin ligjor dhe orientimet e përgjithshme të politikës rinore. Autoriteti federal mbështet dhe nxit aktivitetet e Jugendhilfe me rëndësi ndërajonale dhe qeveria këshillohet nga Këshilli Federal për Rininë (Bundesjugendkuratorium) për çështjet themelore të politikës rinore. Ai është një organ këshillimor që ofron ekspertizë dhe këshillon Qeverinë Federale për çështjet e politikave për fëmijët dhe të rinjtë.


Niveli i landeve (Länder) ka rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe mbështetjen e sistemit të Jugendhilfe. Ligji kërkon që autoritetet e landeve të nxisin zhvillimin e Jugendhilfe, të mbështesin ofruesit publikë dhe të pavarur dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të institucioneve dhe shërbimeve. Në këtë nivel funksionojnë edhe Autoritetet Rajonale për Shërbimet e Fëmijëve dhe të Rinjve (Landesjugendämter), të cilat kanë përgjegjësi mbi nivelin vendor dhe mbështesin zhvillimin e shërbimeve.

Në nivel vendor ekziston Autoriteti Vendor për Fëmijët, të Rinjtë dhe Familjet (Jugendamt), ai është institucioni kryesor për planifikimin dhe organizimin e shërbimeve që funksionon përmes dy strukturave: Komiteti i Shërbimeve Rinore (Jugendhilfeausschuss) dhe ofruesit e pavarur të shërbimeve (Freie Jugendhilfe). Kjo strukturë kombinon vendimmarrjen dhe përfaqësimin me administrimin profesional të shërbimeve.

Koordinimi ndërinstitucional organizohet midis institucioneve në nivel federal, landeve, autoriteteve vendore dhe ofruesit e pavarur, që bashkëpunojnë në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve. Ai përfshin dhe institucione që ndikojnë në jetën e të rinjve, përfshirë shkollat, shërbimet shëndetësore, shërbimet e punësimit, institucionet e formimit profesional, shërbimet sociale dhe strukturat e drejtësisë.

Mekanizmat e koordinimit ndërinstitucional janë konferencat e përbashkëta, strukturat koordinuese ose mekanizma të tjerë të përshtatshëm.

Organizatat e shoqërisë civile përbëjnë pjesën e ofruesve të pavarur të shërbimeve, ata përfshihen në të gjithë ciklet e ofrimit të shërbimit dhe janë pjesë strukturore e sistemit të shërbimeve. Në bazë të marrëveshjes së realizuar me institucionet shtetërore, këto organizata mund të ofrojnë shërbime, programe dhe aktivitete rinore, ndërsa autoritetet publike kanë përgjegjësinë për sigurimin e përgjithshëm të sistemit. Kur ekzistojnë ofrues të pavarur të përshtatshëm, ligji parashikon që autoritetet publike, në parim, të përdorin dhe mbështesin këto kapacitete në vend që të krijojnë vetë oferta paralele.



Politika rinore

Politika rinore është ndërsektoriale, ajo karakterizohet nga një qasje pjesëmarrëse dhe e orientuar drejt krijimit të kushteve që të rinjtë të zhvillohen, të marrin pjesë në shoqëri dhe të përballojnë sfidat e tranzicionit drejt moshës së rritur. Politika rinore nuk kufizohet vetëm te ofrimi i shërbimeve sociale për të rinjtë, por lidhet me fusha të tilla, si: arsimi, punësimi, pjesëmarrja demokratike, përfshirja sociale, lëvizshmëria, digjitalizimi, kultura, shëndeti dhe zhvillimi territorial.

Një parim i rëndësishëm është pjesëmarrja e të rinjve në hartimin dhe zbatimin e politikave që i prekin. Një shembull konkret është hartimi i Strategjisë Federale për Rininë në këtë fushë, ku u zhvillua përmes konsultimeve dhe formateve të ndryshme të dialogut me të rinjtë dhe synoi që perspektiva e tyre të merrej parasysh në fusha të ndryshme të politikave publike. Kjo qasje është zhvilluar më tej përmes Plani Kombëtar i Veprimit për Pjesëmarrjen e Fëmijëve dhe të Rinjve, i cili synon forcimin e mundësive për pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve.

Politikat e fëmijëve dhe të rinjve synojnë të reduktojnë disavantazhet dhe të krijojnë mundësi për pjesëmarrje sociale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të rinjve që kanë nevojë për mbështetje, duke ngritur një sistem gjithëpërfshirës. Politika rinore gjermane karakterizohet gjithashtu nga lidhja midis politikës kombëtare dhe zbatimit territorial. Ndërsa niveli federal përcakton kuadrin dhe mbështet programe me rëndësi kombëtare, landet dhe autoritetet lokale luajnë rol të rëndësishëm në përshtatjen dhe ofrimin konkret të shërbimeve për të rinjtë. Në këtë kuptim, politika rinore lidhet drejtpërdrejt me planifikimin lokal dhe me rrjetin e ofruesve publikë dhe të pavarur.

5.2 Sistemi i shërbimeve për të rinjtë - Jugendhilfe

Jugendhilfe përfaqëson një sistem të gjerë dhe të decentralizuar shërbimesh për fëmijët, të rinjtë dhe familjet. Ai nuk kufizohet në një lloj të vetëm shërbimi, por përfshin ndërhyrje parandaluese, socio-edukative, këshilluese, mbështetëse dhe mbrojtëse. Nga këndvështrimi i shërbimeve për të rinjtë, sistemi përfshin ndër të tjera:

- **Jugendarbeit** – puna rinore, e cila përfshin aktivitete edukative jashtëshkollore, kulturore, sportive, sociale dhe komunitare, si dhe forma të këshillimit dhe mbështetjes për të rinjtë;
- **Jugendsozialarbeit** – puna sociale me të rinjtë, e orientuar veçanërisht drejt të rinjve që përballen me disavantazhe sociale ose vështirësi në arsim, formim profesional, punësim dhe integrim social;
- **Schulsozialarbeit** – puna sociale në shkolla, e cila lidh mbështetjen sociale dhe edukative me mjedisin shkollor dhe ndihmon në parandalimin e përjashtimit dhe vështirësive sociale;
- **Shërbimet e këshillimit dhe mbështetjes**, që u ofrohen të rinjve dhe familjeve sipas nevojave të tyre;
- **Masat e mbrojtjes dhe mbështetjes**, të orientuara drejt sigurisë, mirëqenies dhe zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve.

Shërbimet mund të ofrohen në struktura të ndryshme: qendra rinore, qendra komunitare, shkolla, qendra këshillimi, struktura sociale dhe hapësira të tjera komunitare. Krahas shërbimeve të bazuara në një strukturë fizike, përdoren edhe forma të punës që zhvillohen drejtpërdrejt në komunitet dhe në hapësirat ku ndodhen të rinjtë.

Një karakteristikë e rëndësishme është qasja me pengesa të ulëta. Në varësi të llojit të shërbimit, të rinjtë mund të kontaktojnë drejtpërdrejt ofruesin, strukturën vendore, organizatën që ofron shërbimin ose një qendër rinore. Për shërbimet që kërkojnë ndërhyrje të specializuar, mbështetja mund të lidhet me mekanizma referimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve.

Kjo e bën sistemin më shumë një rrjet shërbimesh sesa një pikë të vetme ofrimi. Një i ri mund të ketë kontakt fillestar me një qendër rinore, shkollën, një organizatë të pavarur ose një shërbim social dhe, sipas nevojës, të orientohet drejt një shërbimi tjetër.

Një tjetër karakteristikë është shumëllojshmëria e ofruesve. Autoritetet publike ruajnë përgjegjësinë për sigurimin e sistemit, ndërsa organizatat e pavarura dhe ofrues të tjerë kontribuojnë në zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve. Kjo krijon mundësi për përdorimin e ekspertizës së ndryshme dhe përshtatjen e ofertës me nevojat lokale.

Pjesëmarrja e të rinjve është pjesë e vetë funksionimit të sistemit. Të rinjtë nuk trajtohen vetëm si përfitues të shërbimeve, por edhe si përdorues, bashkëbisedues dhe pjesëmarrës në proceset që lidhen me ofertat dhe vendimet që i prekin.


5.3 Legjislacioni dhe dokumentet strategjike

Sistemi gjerman i shërbimeve për të rinjtë mbështetet në një kombinim të kuadrit ligjor federal, strategjive ndërsektoriale dhe dokumenteve kombëtare të politikave. Legjislacioni kombëtar përcakton ofrimin e një sistemi të integruar shërbimesh sesa një kuadër për një shërbim të vetëm. Pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tyre, është e detyrueshme në vendimet për sistemin e shërbimeve publike.

Në nivel politikash, Strategjia Federale për Rininë siguron një qasje ndërsektoriale, ndërsa dokumentet kombëtare për pjesëmarrjen dhe reformat ligjore, kanë forcuar orientimin drejt pjesëmarrjes, përfshirjes dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve. Gjithashtu është miratuar dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Pjesëmarrjen e Fëmijëve dhe të Rinjve – instrument për forcimin e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve në vendimmarrje. Legjislacioni dhe dokumentet strategjike i nënshtrohen ndryshimeve të vazhdueshme në përputhje me ndryshimet shoqërore dhe nevojat e të rinjve.

Standardet për shërbimet.

Në Gjermani nuk ekziston një dokument zyrtar kombëtar që miraton standardet për shërbimet për të rinjtë. Gjermania ka vendosur parime të përgjithshme të detyrueshme të cilat janë të hartuara dhe miratuara në nivel federal dhe ato përkthehen në standarde më të detajuara në nivel landi dhe vendor. Legjislacioni në fuqi detyron institucionet dhe ofruesit e pavarur të zhvillojnë dhe zbatojnë kritere për monitorimin dhe vlerësimin e sistemit të shërbimeve. Standardet i nënshtrohen një procesi të vazhdueshëm ndryshimi dhe përmirësimi.



5.4 Karakteristikat kryesore të modelit



5.5 Faktorët që kontribuojnë në funksionimin e modelit

- ✓ **Mbështetja institucionale -** Kuadri i qartë ligjor i përcakton përgjegjësitë dhe të drejtat. Vetëqeverisja vendore ka një rol të përcaktuar në planifikimin, koordinimin dhe sigurimin e shërbimeve në nivel vendor. Planifikimi krijon lidhjen ndërmjet nevojave të identifikuara dhe ofertës së shërbimeve. Përgjegjësitë e ndara të institucioneve mundësojnë përshtatjen e shërbimeve me kontekstin lokal.
- ✓ **Projektimi i orientuar nga përdoruesi -** Shërbimet planifikohen duke marrë në konsideratë nevojat, interesat dhe situatën konkrete të të rinjve. Oferta nuk kufizohet në një model të vetëm, por përshtatet sipas nevojave lokale. Të rinjtë konsiderohen jo vetëm si përfitues, por edhe si aktorë në përcaktimin e shërbimeve që u nevojiten. Qasja me pengesa të ulëta lehtëson kontaktin e parë me shërbimin.
- ✓ **Stafi i trajnuar dhe profesional -** Shërbimet mbështeten nga profesionistë të fushës sociale, edukative dhe rinore. Kompetencat profesionale përshtaten me llojin e shërbimit dhe nevojat e grupit të synuar. Bashkëpunimi ndërdisiplinor mundëson trajtimin e nevojave komplekse të të rinjve. Zhvillimi profesional kontribuon në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.
- ✓ **Koordinimi -** Jugendhilfe funksionon përmes një rrjeti aktorësh dhe shërbimesh, në vend të një strukture të izoluar. Institucione publike vendosin të bashkëpunojnë me ofruesit e pavarur, shkollat, shërbimet shëndetësore, punësimin, arsimin profesional dhe aktorë të tjerë. Mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstitucional lehtësojnë referimin dhe vazhdimësinë e mbështetjes dhe zgjeron kapacitetin e sistemit.
- ✓ **Mjetet digjitale -** Kanalet digjitale plotësojnë kontaktin fizik dhe përdoren për informim, komunikim dhe orientim. Ato mund të ulin pengesat e aksesit, veçanërisht për informacionin fillestar. Komunikimi digjital krijon kanale më të përshtatshme për mënyrën

se si të rinjtë kërkojnë dhe marrin informacion. Digjitalizimi funksionon si element mbështetës dhe jo si zëvendësim i plotë i kontaktit njerëzor.

- ✓ **Pjesëmarrja e të rinjve -** Pjesëmarrja e të rinjve është e integruar në kuadrin e Jugendhilfe. Të rinjtë përfshihen në çështjet që i prekin drejtpërdrejt. Nevojat, interesat dhe perspektiva e të rinjve merren në konsideratë në planifikimin dhe zhvillimin e ofertave. Pjesëmarrja ndihmon që shërbimet të jenë më të përshtatura me përdoruesit.
- ✓ **Financimi i qëndrueshëm -** Mbështetja publike krijon bazën financiare për funksionimin e vazhdueshëm të sistemit. Përgjegjësitë financiare shpërndahen ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe sipas llojit të shërbimit. Bashkëpunimi me ofruesit e pavarur mundëson mobilizimin e kapaciteteve dhe burimeve të ndryshme. Vazhdimësia e financimit është e rëndësishme për qëndrueshmërinë e stafit, shërbimeve dhe marrëdhënieve me të rinjtë.
- ✓ **Monitorimi dhe marrja e mendimeve -** Planifikimi i Jugendhilfe mbështetet në analizën e nevojave dhe të ofertës ekzistuese. Të dhënat mbi përdorimin dhe nevojat ndihmojnë në përshtatjen e shërbimeve. Mendimi i të rinjve është burim informacioni për cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve. Monitorimi dhe vlerësimi krijojnë bazën për përmirësim të vazhdueshëm, në vend që shërbimet të mbeten statike.

6. GREQIA

6.1 Kuadri institucional dhe qeverisës

Modeli grek i qeverisjes së shërbimeve rinore është i decentralizuar dhe ndërsektorial, ku politikat dhe shërbimet për të rinjtë zhvillohen përmes bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qendrore, autoriteteve rajonale, bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile. Përgjegjësitë për rininë nuk përqendrohen në një institucion të vetëm, por lidhen me fusha si arsimi, punësimi, shëndetësia, përfshirja sociale, kultura, sporti dhe pjesëmarrja qytetare.


Në nivel kombëtar, Këshilli i Ministrave përcakton orientimet kombëtare për politikën rinore, zhvillon programe dhe koordinon ndërhyrjet ndërsektoriale. Drejtoria e Rinisë është pjesë e Ministrisë së Kohezionit Social dhe Familjes dhe është përgjegjëse për koordinimin dhe zbatimin e politikave rinore, për hartimin dhe vlerësimin e programeve dhe për koordinimin me ministritë, rajonet, bashkitë dhe organizmat e tjerë në zhvillimin e të rinjve.

Në nivel rajonal, rajonet veprojnë si nivel ndërmjetësues ndërmjet politikave kombëtare dhe zbatimit vendor. Ato mund të mbështesin dhe koordinojnë programe në fusha që prekin të rinjtë, duke përfshirë arsimin, përfshirjen sociale, punësimin, shëndetësinë dhe zhvillimin territorial. Në këtë mënyrë, shërbimet rinore nuk organizohen vetëm nga një strukturë kombëtare, por përshtaten me nevojat dhe kapacitetet e territoreve.

Në nivel vendor, bashkitë janë aktorët kryesorë të zbatimit të politikave rinore. Bashkitë mund të zhvillojnë programe dhe shërbime për të rinjtë përmes strukturave të tyre, duke i lidhur politikat rinore me fusha të ndryshme për të cilat janë përgjegjëse, si: arsimi, kultura, sporti, pjesëmarrja qytetare etj. Në bashki krijohen Këshillat Bashkiakë të të Rinjve, që shërbejnë si mekanizma të pjesëmarrjes së të rinjve në çështjet lokale dhe për identifikimin e nevojave të tyre. Ata synojnë të identifikojnë e përcjellin nevojat dhe problemet e të rinjve dhe të forcojnë pjesëmarrjen e tyre në çështjet lokale.

Koordinimi ndërinstitucional lidh politikën rinore me politika të tjera publike, ku Drejtoria e Rinisë ka ndër detyrat koordinimin e ministrive, rajoneve, bashkive dhe organizmave të tjerë për zhvillimin e sinergjive dhe programeve të përbashkëta për rininë.

Ofruesit e shërbimeve përfshijnë: strukturat publike; bashkitë; institucionet arsimore dhe shëndetësore; organizatat e shoqërisë civile; organizatat rinore; organizatat sociale dhe komunitare. Ofrimi i shërbimeve me një shumëllojshmëri ofertuesish na krijon një ekosistem shërbimeve, që fillon nga marrja e informacionit, edukim, mbështetje sociale, shërbime shëndetësore, orientim profesional ose mbështetje psikosociale nga struktura të ndryshme.



Politika rinore

Politika rinore zhvillohet si një politikë ndërsektoriale, e lidhur me disa politika të tjera publike si arsimin, punësimin, përfshirjen sociale, shëndetësinë, pjesëmarrjen qytetare, kulturën dhe zhvillimin lokal. Përgjegjësitë institucionale për rininë janë të shpërndara ndërmjet strukturave qendrore, vendore dhe aktorëve territorialë, ndërsa zbatimi konkret realizohet përmes programeve dhe shërbimeve në nivel vendor.

Një rol të rëndësishëm ka Drejtoria e Rinisë, e cila harton politika rinore që lidhen ngushtë me objektivat e përfshirjes sociale, mbështetjes së të rinjve dhe forcimit të pjesëmarrjes së tyre. Një element konkret i politikës rinore greke është "National Youth Capital", duke u vendosur dhe si një nga objektivat kryesore të Ministrisë Kohezionit Social dhe Familjes. Programi synon të nxisë pjesëmarrjen e të rinjve 15–29 vjeç në jetën e komunitetit, të forcojë lidhjet ndërmjet të rinjve dhe autoriteteve lokale dhe të inkurajojë bashkitë të zhvillojnë veprime dhe strategji lokale për rininë.

Politikat rinore janë të lidhura me shërbime konkrete të ofruar në fusha të ndryshme dhe ku grupet vulnerabël duhet që të jenë përfitues pa pengesa ose me pengesa të ulëta të këtyre shërbimeve.

Sistemi i shërbimeve për të rinjtë.

Sistemi i shërbimeve për të rinjtë është një ekosistem shërbimesh të shpërndara në sektorë dhe nivele të ndryshme, dhe jo si një rrjet i vetëm kombëtar me një paketë standarde ShMR. Sistemi i shërbimeve organizohet me shërbime dhe struktura që mbulojnë pjesëmarrjen, shëndetin, përfshirjen sociale, arsimin, punësimin dhe mbështetjen e të rinjve:

- **Informim dhe orientim** - Informim për mundësitë, të drejtat, arsimin, trajnimin, punësimin dhe programet për të rinjtë.

- **Arsim dhe aftësi** - Arsim, formim profesional, mësim gjatë gjithë jetës dhe zhvillim aftësish.
- **Punësim** - Orientim profesional, aktivizim dhe mbështetje për hyrjen në tregun e punës.
- **Shëndet dhe mirëqenie** - Shërbime shëndetësore për adoleshentët, parandalim, këshillim dhe mbështetje psikosociale.
- **Përfshirje sociale** - Mbështetje për të rinjtë dhe familjet që hasin pengesa, përfshirë shërbime sociale dhe mbështetje të specializuar.
- **Pjesëmarrje** - Këshillat Bashkiakë të të Rinjve, konsultim, iniciativa lokale dhe mekanizma për pjesëmarrjen në vendimmarrje.
- **Kulturë, sport dhe komunitet** - Aktivitete kulturore, sportive, krijuese dhe komunitare, kryesisht në nivel lokal.
- **Shërbime për grupe specifike** - Shërbime të përshtatura për të rinjtë me aftësi të kufizuara ose në situata të veçanta sociale.
- **Njësitë e Shëndetit për Adoleshentët** - janë një model i specializuar brenda sektorit shëndetësor, jo i gjithë sistemi i shërbimeve rinore.


6.2 Legjislacioni dhe dokumentet strategjike

Legjislacioni grek për rininë nuk është i organizuar si një ligj i vetëm, ai është më shumë një kuadër i shpërndarë ndërmjet politikave dhe ligjeve sektoriale, me rininë të lidhur me arsimin, punësimin, përfshirjen sociale, shëndetësinë, pjesëmarrjen dhe qeverisjen vendore. Kjo përputhet edhe me kuadrin strategjik të Greqisë për rininë, i cili përfshin fusha si punësimi, arsimi, strehimi, kohezioni social dhe mirëqenia.

Ky kuadër plotësohet nga strategji kombëtare dhe mekanizma vendorë të pjesëmarrjes së të rinjve, duke krijuar bazën për një ekosistem të larmishëm shërbimesh. Strategjia “Rinia 17-27”, është Strategjia Kombëtare e rinisë e zhvilluar në 7 shtylla kryesore për konsolidimin e kushteve të autonomisë dhe barazisë për të rinjtë.

Standardet për shërbimet.

Greqia nuk ka një paketë të vetme kombëtare të standardeve për të gjitha ShMR.



6.3 Modeli i Shërbimeve Miqësore për të Rinjtë: Njësitë e Shëndetit për Adoleshentët

Greqia ka zhvilluar NjShA, të ngritura si mjedise multidisiplinare, bazuar në udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për ShMR.

NjShA është një strukturë shërbimi e fokusuar te shëndeti dhe mirëqenia e adoleshentëve, ajo nuk është një pikë e izoluar, por pjesë e rrjetit të kujdesit shëndetësor dhe e marrëdhënieve me shkollat, familjet dhe shërbimet e tjera kur nevojitet referim ose mbështetje shtesë. Qasja është multidisiplinare, ku një shërbim i specializuar lidhet me sistemin më të gjerë të shërbimeve. Profesionistë të ndryshëm bashkëpunojnë për të adresuar nevojat e adoleshentit dhe synojnë të kombinojnë kujdesin, parandalimin, informimin dhe këshillimin. Shërbimi mund të adresojë çështje të shëndetit fizik dhe psikologjik, edukimin shëndetësor dhe nevoja të tjera që lidhen me zhvillimin dhe mirëqenien e adoleshentëve. Shërbimi është i orientuar kryesisht drejt adoleshentëve të grupmoshës 10–19 vjeç. Në varësi të shërbimit konkret dhe kuadrit kombëtar, mund të ketë ndërveprim edhe me prindërit, familjet, shkollat dhe profesionistë të tjerë.

NjShA janë pjesë e financimit publik të sistemit shëndetësor, ndërsa mbështetja për shërbimet dhe programet specifike mund të lidhet edhe me programe kombëtare dhe partneritete institucionale. Modeli lidhet me strukturat shëndetësore dhe rrjetin e kujdesit shëndetësor, duke e vendosur shërbimin sa më pranë mjediseve ku adoleshentët jetojnë, mësojnë dhe kërkojnë mbështetje.

NjShA karakterizohet nga aksesi në shërbim i thjeshtë, i kuptueshëm dhe i përshtatur me nevojat e adoleshentëve, duke reduktuar pengesat që mund t'i pengojnë ata të kërkojnë shërbim. Këtu përfshihen informacioni i qartë, mjedisi miqësor, respektimi i privatësisë dhe konfidencialitetit, si dhe mundësia për t'u orientuar ose referuar drejt shërbimeve të tjera kur nevojitet.

6.4 Karakteristikat kryesore të modelit



6.5 Faktorët që kontribuojnë në funksionimin e modelit

- ✓ **Mbështetja institucionale -** Integrimi i shërbimit brenda sistemit shëndetësor i jep modelit një bazë institucionale dhe mundëson lidhjen me strukturat e tjera të kujdesit.
- ✓ **Projektimi i orientuar nga përdoruesi -** Shërbimi organizohet rreth karakteristikave dhe nevojave të adoleshentëve: akses i lehtë, komunikim i përshtatur, privatësi, konfidencialitet dhe mjedis miqësor.
- ✓ **Stafi i trajnuar dhe profesional -** Qasja multidisiplinare kërkon profesionistë me kompetenca për të punuar me adoleshentët dhe për të identifikuar nevoja që shkojnë përtej një problemi të vetëm shëndetësor.
- ✓ **Koordinimi -** Lidhja me profesionistë dhe shërbime të tjera mundëson një përgjigje më të integruar dhe shmang fragmentimin e mbështetjes. Referimi është veçanërisht i rëndësishëm për rastet që kërkojnë mbështetje të specializuar.
- ✓ **Mjetet digjitale -** Mjetet digjitale mund të zgjerojnë aksesin në informacion dhe komunikim me adoleshentët dhe të plotësojnë kontaktin fizik me shërbimin.
- ✓ **Pjesëmarrja e të rinjve -** Dëgjimi i adoleshentëve dhe përfshirja e perspektivës së tyre ndihmon që shërbimi të jetë realisht i përshtatur me mënyrën se si ata e përjetojnë dhe e përdorin atë.
- ✓ **Financimi i qëndrueshëm -** Financimi publik dhe integrimi në strukturat ekzistuese shëndetësore krijojnë kushte për vazhdimësi; qëndrueshmëria financiare mbetet një kusht i rëndësishëm për ruajtjen e stafit, aktiviteteve dhe cilësisë.

- ✓ **Monitorimi dhe marrja e mendimeve -** Mbledhja e të dhënave, mendimeve të përdoruesve dhe vlerësimi periodik mundësojnë identifikimin e pengesave dhe përshtatjen e shërbimit me nevojat në ndryshim.

7. ANALIZË KRAHASUESE E MODELEVE DHE PRAKTIKAVE

7.1 Analizë krahasuese e kuadrit institucional dhe organizues

Kjo analizë tregon se të tre modelet e vendosin përgjegjësinë publike për shërbimet brenda një kuadri që përfshin edhe aktorë të tjerë territorialë dhe socialë, por qasjet e tyre organizative ndryshojnë. Gjermania paraqet modelin më të strukturuar – një sistem të integruar shërbimesh – ndërsa Italia mbështetet më shumë në organizimin territorial dhe larmishërmi shërbimesh. Greqia, nga ana tjetër, paraqet një ekosistem më sektorial dhe ndërsektorial, ku shërbimet për të rinjtë janë të shpërndara në fusha dhe struktura të ndryshme.

Elementi	*Itali*	*Gjermani*	*Greqi*
Praktika e Mirë	Qendrat e Agregimit Rinor	Jugendhilfe	Njësitë e Shëndetit për Adoleshentët
Kuadri ligjor	Kombëtar + Rajonal + vendor.	Kombëtar.	Kombëtar + vendor
Modeli i qeverisjes	Disa nivele dhe territorial.	Disa nivele dhe i decentralizuar.	Disa nivele dhe ndërsektorial.
Sistemi i shërbimeve	Territorial	I integruar dhe i decentralizuar.	I shpërndarë midis sektorëve dhe niveleve.
Pushteti qendror	Orientim, politika dhe financim.	Kuadër ligjor dhe orientim kombëtar.	Politika, programe dhe koordinim.
Pushteti vendor	Shumë i rëndësishëm në organizimin e shërbimeve.	Shumë i rëndësishëm.	Bashkitë zbatojnë dhe përshtatin politikat.
Planifikimi	E shpërndarë midis niveleve	E lidhur me planifikimi vendor	E shpërndarë midis qendrorit dhe vendorit.
Ofruesit e shërbimeve	Bashki + ofruesit privat + organizata rinore.	Publikë + Ofruesit e pavarur + OJF.	Publikë + shërbime sektoriale + OJF.
Koordinimi i shërbimeve	Rrjet territorial.	Strukturat vendore + rrjet ndërsektorial.	Bashkëpunim ndërministror dhe ndërsektorial
Financimi	Kombëtar + territorial + BE	Fonde publike.	Fonde publike + BE + programe.

7.2 Analizë krahasuese e standardeve të ofrimit të shërbimeve

Dimensioni	*Itali – QAR*	*Gjermani – Jugendhilfe*	*Greqi – NjShA*
Qasshmëria	Akses i hapur, vullnetar dhe pengesa të ulëta.	Pengesa të ulëta; nevojat e të rinjve; grupet vulnerabël.	Pengesa të ulëta; nevojat e të rinjve; privatësi, konfidencialitet, komunikimi i përshtatshëm.
Informacioni	Pikë informim, orientim dhe lidhje me burimet e territorit.	Informim, këshillim, identifikim shërbimi, gjuhë e kuptueshme.	Informim, këshillim, gjuhë e përshtatshme për adoleshentët.
Pjesëmarrja	Të rinjtë marrin pjesë, përcaktues në aktivitete.	Bashkëkrijim dhe bashkëvendim.	Adoleshentët aktorë aktiv në kujdes dhe këshillim.
Përfshirja	Të rinj me nevoja të ndryshme.	Përshtatja e shërbimeve sipas nevojave.	Përshtatja e shërbimeve sipas nevojave dhe grupeve vulnerabël pjesë e politikave.
Cilësia	Nivel rajonal dhe lokal: aktiviteteve rekreative me punën socio-edukative, mbështetjen profesionale.	Profesionalizëm, vazhdimësi, përshtatshmëri dhe përmirësim.	Profesionalizëm, qasje multidisiplinare, privatësi, nevoja specifike.
Digjitalizimi	Komunikim, informim, regjistrim, angazhim, zgjerim kanalesh komunikimi.	Shërbime fizike, kontakt.	Informim, komunikim, shërbime fizike, kontakt
Referimi	Pikë lidhëse me shërbimet e tjera.	Rrjet shërbimesh, bashkëpunim koordinim ndërinstitucional jo fragmentim.	Pika hyrëse dhe lidhëse me të tjerët.
Shtrirje	Lidhje me komunitetin, institucionet arsimore, OJF, shërbimet lokale.	Të rinjtë që nuk vijnë tek shërbimi; bashkëpunim me institucionet, kontakt në mjedisin e tyre, eliminim pengesa.	Bashkëpunim me institucionet shkolla dhe komunitet, të rinjtë që nuk kërkojnë shërbim.
M&V	Pjesëmarrja, realizimi i shërbimit. Marrja e mendimeve sjellë përshtatjen e programeve.	I gjithë cikli i shërbimeve, analizë nevojash, marrje mendimi, përmirësim i vazhdueshëm.	I gjithë cikli i shërbimeve, analizë nevojash, marrje mendimi, përmirësim i vazhdueshëm.

7.3 Përmbledhje krahasuese

Krahasimi i tre modeleve tregon se nuk ekziston një mënyrë e vetme për organizimin e ShMR. Secili model lidh 5 dimensionet e ShMR me një strukturë të ndryshme institucionale.

Dimensioni	*Itali*	*Gjermani*	*Greqi*
Logjika e modelit	Shërbime dhe hapësira rinore të përshtatura me territorin	Sistem i integruar i shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë	Shërbime të shpërndara ndërmjet sektorëve dhe niveleve.
Pikat e kontaktit	Qendra dhe hapësira rinore, si dhe shërbime lokale	Rrjet i gjerë strukturash dhe shërbimesh	Strukturë ose shërbim sektorial, sipas nevojës
Marrëdhënia me territorin	Përshtatje e fortë territoriale	Planifikim vendor i institucionalizuar	Përshtatje përmes bashkive dhe strukturave lokale
Roli i ofruesve	Shumëllojshmëri ofruesish dhe forma shërbimi	Partneritet i strukturuar publik–ofrues të pavarur	Përzierje e strukturave publike dhe sektoriale me OJF
Pjesëmarrja	E lidhur me hapësirat dhe aktivitetet rinore	E integruar në sistemin e Jugendhilfe	E lidhur me mekanizmat e pjesëmarrjes dhe shërbimin
Qasja ndaj aksesueshmërisë	Akses i hapur dhe pengesa të ulëta	Akses sipas nevojave dhe pengesa të reduktuara	Akses i përshtatur me nevojat e përdoruesit
Koordinimi i shërbimeve	Rrjete territoriale	Koordinim sistemik dhe ndërsektorial	Koordinim ndërmjet sektorëve dhe niveleve
Karakteristika më e dallueshme	Hapësira rinore dhe fleksibiliteti territorial	Integrimi dhe decentralizimi i sistemit	Orientimi i shërbimit specifik drejt përdoruesit

7.4 Faktorët e përbashkët që kontribuojnë në funksionimin e modeleve

7.4.1. Faktorët e përbashkët të suksesit

Megjithëse Italia, Gjermania dhe Greqia kanë modele të ndryshme institucionale dhe mënyra të ndryshme organizimi të shërbimeve, analiza identifikon disa elemente të përbashkëta që kontribuojnë në krijimin dhe funksionimin e ShMR.

- **Kuadri institucional -** Përcaktimi i përgjegjësive ndërmjet niveleve dhe institucioneve krijon bazën për organizimin e shërbimeve.
- **Orientimi drejt përdoruesit** - Shërbimet marrin në konsideratë moshën, nevojat, situatën dhe përvojën e të rinjve.
- **Qasshmëria dhe pengesa të ulëta** - Përpjekja për ta bërë kontaktin me shërbimin sa më të thjeshtë, të kuptueshëm dhe të përshtatshëm për përdoruesin.
- **Pjesëmarrja e të rinjve** - Të rinjtë përfshihen në konsultim, planifikim, zhvillim ose vlerësim të ofertës, në forma të ndryshme sipas modelit.
- **Profesionalizmi** - Shërbimet mbështeten në staf me kompetenca të përshtatshme dhe, kur është e nevojshme, në ekipe multidisiplinare.
- **Koordinimi dhe referimi** - Shërbimet lidhen me njëra-tjetrën dhe krijojnë mundësi për orientim dhe vazhdimësi të mbështetjes.
- **Përshtatja territoriale** - Modelet lejojnë një shkallë të caktuar përshtatjeje me nevojat dhe kapacitetet e territorit.
- **Monitorimi dhe marrja e mendimeve** - Informacioni mbi përdorimin, nevojat dhe përvojën e të rinjve përdoret për përshtatjen dhe përmirësimin e ofertës.
- **Mbështetja financiare dhe institucionale** - Qëndrueshmëria e shërbimeve kërkon burime dhe integrim në mekanizmat institucionalë ekzistues.
- **Komunikimi dhe kanalet digjitale** - Informacioni dhe komunikimi digjital përdoren si kanale plotësuese për ta bërë shërbimin më të arritshëm për të rinjtë.

7.5 Dallimet kryesore

Dimensioni	Itali	Gjermani	Greqi
Logjika e modelit	Model shumë-nivelesh, me rol të rëndësishëm të Rajoneve dhe Bashkive	Sistem i integruar, i mbështetur në ligj	Politikë rinore kombëtare e kombinuar me programe dhe mekanizma vendorë
Shpërndarja e kompetencave	Kompetenca të ndara ndërmjet shtetit, Rajoneve dhe pushtetit vendor	Kompetenca të forta të niveleve të landeve dhe autoriteteve vendore	Rol më i dukshëm i nivelit qendror, me zbatim dhe iniciativa në nivel vendor
Struktura lokale	Bashki/Rajone dhe struktura territoriale për rininë	Vendore + Komiteti për Mirëqenien e të Rinjve (Jugendhilfeausschuss)	Bashki + struktura/këshilla vendorë të rinisë
Planifikimi i shërbimeve	I lidhur me planifikimin territorial dhe politikat rajonale	Planifikimi i ndihmës për të rinjtë si instrument i institucionalizuar	Më shumë i lidhur me strategji, programe dhe iniciativa lokale
Roli i ofruesve jo-publikë	Partneritet me OJF dhe organizata rinore	Organizata të pavarura janë pjesë strukturore e sistemit	OJF dhe organizatat rinore si partnerë në programe dhe iniciativa
Qasja ndaj shërbimeve	Qasje komunitare, territoriale dhe socio-edukative	Qasje e integruar sociale, parandaluese dhe individuale	Qasje e specializuar, parandaluese dhe e orientuar ndaj nevojave të adoleshentëve
Informimi i të rinjve	Infrastrukturë e zhvilluar e informacionit rinor, përfshirë Informagiovani dhe kanale digjitale	Informim dhe këshillim i integruar në shërbimet e Jugendhilfe	Informim për mundësi, pjesëmarrje dhe programe rinore
Pjesëmarrja	Përmes strukturave dhe mekanizmave të ndryshëm rinorë	E lidhur me vendimmarrjen dhe planifikimin e Jugendhilfe	Më e dukshme në nivelin vendor, përmes këshillave rinore
Digjitalizimi	Rol relativisht i fortë në informacion dhe akses	Plotëson shërbimet fizike dhe këshillimin	Në zhvillim krahas mekanizmave tradicionalë
Financimi	Kombinim i burimeve kombëtare, rajonale dhe vendore	I lidhur ngushtë me përgjegjësitë publike dhe sistemin Jugendhilfe	Kombinim i financimit publik dhe programeve të dedikuara
Qëndrueshmëria	Mbështetet te integrimi në nivelet territoriale	E institucionalizuar në mënyrë të fortë përmes kuadrit ligjor	Varet më shumë nga integrimi në politika dhe struktura/programet vendore
Veçoria dalluese	Rrjet territorial dhe shumë-nivelesh	Sistem i institucionalizuar i shërbimeve	Aktivizim i nivelit vendor dhe pjesëmarrjes rinore

Italia dhe modeli i QAR:

"*Modeli fokusohet tek hapësira dhe komuniteti. QAR krijon një pikë të aksesueshme ku të rinjtë mund të takohen, marrin mbështetje, zhvillojnë aktivitete dhe lidhen me shërbime të tjera*."

Gjermania dhe modeli Jugendhilfe:

*Modeli fokusohet te **sistemi dhe koordinimi**. Jugendhilfe nuk është një shërbim i vetëm, por një sistem i planifikuar sipas nevojave, ku shërbime të ndryshme publike dhe jo-publike lidhen në një rrjet."*

Greqia dhe modeli i NjShA

"*Modeli fokusohet te **përshtatja e shërbimit me përdoruesin**. NJSHa tregon se si një shërbim specifik mund të riorganizohet rreth nevojave të adoleshentit, duke kombinuar aksesin, privatësinë, cilësinë profesionale, parandalimin dhe referimin."*

8. PËRSHTATJA ME KONTEKSTIN E SHQIPËRISË

8.1 Konteksti aktual shqiptar

Modeli shqiptar i qeverisjes së politikave dhe shërbimeve rinore është i organizuar në mënyrë shumë-nivelesh dhe ndërsektoriale, ku përgjegjësitë për rininë ndahen ndërmjet institucioneve qendrore, Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR), njësive të vetëqeverisjes vendore dhe aktorëve të shoqërisë civile.

Në nivel kombëtar, Këshilli i Ministrave dhe Ministria përgjegjëse për rininë (aktualisht, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Rinisë) përcaktojnë orientimet strategjike dhe politikat kombëtare për rininë, ndërsa kuadri strategjik përcaktohet veçanërisht nga Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029 dhe Plani i saj i Veprimit. Ministria përgjegjëse për rininë ka përgjegjësinë për drejtimin dhe koordinimin e politikës rinore, ndërsa bashkëpunon me ministritë e tjera për integrimin e dimensionit rinor në politikat sektoriale.

AKR është institucioni kryesor publik i specializuar për zbatimin e politikave dhe programeve rinore. Ajo mbështet zbatimin e politikave kombëtare, administron dhe zhvillon programe për të rinjtë, mbështet organizatat rinore dhe kontribuon në forcimin e pjesëmarrjes dhe fuqizimit të të rinjve.


Gjithashtu, në nivel kombëtar organizohet dhe funksionon Këshilli Kombëtar i Rinisë (KKR). KKR është një mekanizëm i strukturuar drejt dialogut midis institucioneve shtetërore qendrore dhe të rinjve në kuadër të politika rinore.

Në nivelin e vetëqeverisjes vendore, bashkitë janë aktorët kryesorë të zbatimit të politikave dhe shërbimeve në territor. Në kuadër të decentralizimit dhe përgjegjësive të vetëqeverisjes vendore, bashkitë mund të zhvillojnë dhe mbështesin iniciativa dhe shërbime që lidhen me të rinjtë, përmes strukturave dhe institucioneve të tyre dhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë vendorë. Në këtë nivel, politikat rinore lidhen me fusha të tilla si shërbimet sociale, kultura, sporti, arsimi joformal, punësimi, hapësirat rinore dhe pjesëmarrja qytetare.

Në nivel vendor funksionojnë Këshillat Vendor të Rinisë (KVR) si mekanizma të pjesëmarrjes së të rinjve në çështjet lokale. KVR synojnë të krijojnë një kanal të strukturuar ndërmjet të rinjve dhe bashkisë, duke kontribuar në identifikimin e nevojave, konsultimin dhe përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse lokale. Kjo krijon një potencial të rëndësishëm për lidhjen e pjesëmarrjes së të rinjve me projektimin dhe përmirësimin e shërbimeve.

Koordinimi ndërinstitucional është një element i rëndësishëm, pasi çështjet që ndikojnë të rinjtë janë të shpërndara në disa politika dhe institucione. Ministria përgjegjëse për rininë dhe AKR, bashkëpunojnë me ministritë e linjës, bashkitë, institucionet publike, KVR-të dhe organizatat e shoqërisë civile për të siguruar që objektivat e politikës rinore reflektohen në ndërhyrje dhe shërbime konkrete.

Ofruesit e shërbimeve përfshijnë: institucionet publike qendrore, bashkitë, institucionet arsimore dhe shëndetësore, ofruesit e shërbimeve sociale, organizatat rinore dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe struktura komunitare dhe aktorë të tjerë publikë ose jopublikë. Kjo krijon një ekosistem të shpërndarë të shërbimeve për të rinjtë, ku një i ri mund të marrë informacion, arsimim dhe orientim, mbështetje sociale, shërbime shëndetësore, orientim profesional, mbështetje psikosociale ose mundësi për pjesëmarrje qytetare nga institucione dhe ofrues të ndryshëm.



Politika rinore

Politika rinore në Shqipëri është e ndërtuar mbi një qasje ndërsektoriale dhe shumë-nivele, ku përgjegjësitë për zhvillimin dhe zbatimin e politikave shpërndahen ndërmjet institucioneve qendrore, ministrisë përgjegjëse për rininë, AKR, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe aktorëve të shoqërisë civile. Politika rinore nuk trajtohet si një fushë e izoluar, por lidhet me arsimin, punësimin dhe aftësitë, mirëqenien dhe përfshirjen sociale, shëndetësinë, kulturën, sportin, pjesëmarrjen qytetare dhe fuqizimin e të rinjve.

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029 përbën dokumentin kryesor strategjik, duke përcaktuar prioritetet, objektivat dhe masat për përmirësimin e kushteve dhe mundësive për të rinjtë. Politika rinore ndërthuret me politikat sektoriale të ministrive të tjera, duke kërkuar integrimin e perspektivës së të rinjve në fusha të ndryshme të politikave publike.

Në nivel vendor, bashkitë janë përgjegjëse për përshtatjen dhe zbatimin e politikave dhe ndërhyrjeve në përputhje me nevojat e komuniteteve lokale. Politikat vendore për rininë mund të lidhen me shërbimet sociale, arsimin dhe edukimin joformal, kulturën, sportin, punësimin, hapësirat rinore dhe pjesëmarrjen qytetare.

Pjesëmarrja e të rinjve është pjesë e rëndësishme e hartimit të politikës rinore. KVR, organizatat rinore dhe mekanizma të tjerë të konsultimit krijojnë kanale për përfshirjen e të rinjve në identifikimin e nevojave, konsultimin e politikave dhe proceset vendimmarrëse. Kjo krijon mundësinë që politika rinore të zhvillohet jo vetëm për të rinjtë, por edhe me të rinjtë. Zbatimi i politikës rinore mbështetet gjithashtu nga organizatat e shoqërisë civile, organizatat rinore dhe partnerët ndërkombëtarë, të cilët kontribuojnë përmes programeve, projekteve, financimeve, kërkimit, advokimit dhe ngritjes së kapaciteteve. Këta aktorë plotësojnë ndërhyrjet publike dhe krijojnë mundësi shtesë për pjesëmarrjen, zhvillimin e aftësive dhe përfshirjen sociale të të rinjve.

Sistemi i shërbimeve për të rinjtë.

Sistemi shqiptar i shërbimeve për të rinjtë është i shpërndarë dhe ndërsektorial, pasi nuk ekziston një sistem i vetëm i integruar i shërbimeve rinore. Shërbimet që lidhen me nevojat e të rinjve ofrohen nga institucione të ndryshme publike dhe jopublike dhe janë të integruara në sektorë të tillë si arsimi, punësimi, shërbimet sociale, shëndetësia, kultura, sporti, informacioni dhe pjesëmarrja qytetare. Për këtë arsye, i riu mund të ketë nevojë të kontaktojë disa institucione ose ofrues të ndryshëm për të adresuar nevoja të lidhura me njëra-tjetrën.

- **Ministritë dhe institucionet publike përgjegjëse** - për sektorë të ndryshëm hartojnë dhe administrojnë shërbimet në fushat përkatëse.
- **Bashkitë -** ofrojnë dhe koordinojnë shërbime në territor. Në varësi të organizimit vendor, të rinjtë mund të aksesojnë shërbime sociale, aktivitete kulturore e sportive, hapësira rinore, aktivitete të edukimit joformal, informim dhe orientim, si dhe programe të ndryshme të mbështetjes për të rinjtë.
- **Qendrat rinore dhe hapësirat rinore** - mund të funksionojnë si pika kontakti dhe informimi për të rinjtë, duke ofruar ose ndërmjetësuar aktivitete, programe, orientim, edukim joformal, mundësi pjesëmarrjeje dhe lidhje me shërbime të tjera. Roli i tyre mund të ndryshojë sipas territorit dhe modelit të organizimit.
- **Organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat rinore/për të rinjtë** - Ato ofrojnë ose mbështesin shërbime dhe programe në fusha si fuqizimi dhe pjesëmarrja e të rinjve, orientimi profesional, përfshirja sociale, aftësitë, shëndeti dhe mirëqenia, mbështetja psikosociale, vullnetarizmi dhe zhvillimi komunitar. Në shumë raste ato plotësojnë shërbimet publike ose ofrojnë ndërhyrje për grupe specifike të të rinjve.
- **Shërbimet digjitale** - përbëjnë një komponent gjithnjë e më të rëndësishëm të aksesit në shërbime. Platforma si e-Albania mundësojnë akses online në një numër të madh shërbimesh publike.

8.2 Legjislacioni dhe dokumentet strategjike

Kuadri shqiptar për rininë bazohet në legjislacionin specifik për rininë, dokumentet strategjike kombëtare dhe legjislacionin sektorial që rregullon shërbimet dhe të drejtat me rëndësi për të rinjtë.

Ligji nr. 75/2019 “Për Rininë” (i ndryshuar) përbën bazën kryesore ligjore për politikën rinore në Shqipëri. Ligji përcakton parimet, përgjegjësitë institucionale dhe mekanizmat për zhvillimin e politikave rinore, si dhe krijon bazën për pjesëmarrjen e të rinjve dhe funksionimin e strukturave rinore në nivel qendror dhe vendor.


Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029 është dokumenti kryesor strategjik që orienton politikën rinore shqiptare. Ajo vendos objektiva dhe masa në fusha që lidhen me pjesëmarrjen dhe fuqizimin e të rinjve, zhvillimin e aftësive dhe punësimin, mirëqenien, përfshirjen sociale dhe mbështetjen e të rinjve.

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) krijon bazën për rolin e bashkive në adresimin e nevojave të komuniteteve dhe në ofrimin e funksioneve dhe shërbimeve vendore. Legjislacioni sektorial plotëson kuadrin specifik për rininë. Të drejtat dhe nevojat e të rinjve preken nga legjislacioni në fushat e arsimit, punësimit, mbrojtjes sociale, shëndetësisë, mosdiskriminimit, mbrojtjes së të dhënave personale, kulturës, sportit dhe pjesëmarrjes qytetare.

Standardet për shërbimet.

Në Shqipëri, kërkesat dhe standardet për ofrimin e shërbimeve publike përcaktohen kryesisht në mënyrë sektoriale, sipas natyrës së shërbimit dhe kuadrit ligjor e institucional përkatës. Nuk ekziston një kornizë e unifikuar horizontale që të përcaktojë në mënyrë të përbashkët kriteret e shërbimeve të orientuara posaçërisht ndaj të rinjve, pavarësisht sektorit apo ofruesit.

Një i ri që përdor shërbime në fusha të ndryshme mund të përballet me kërkesa, procedura dhe forma të ndryshme të ofrimit. Kjo situatë nuk nënkupton mungesën e standardeve për shërbimet në sektorë të veçantë, por tregon mungesën e një kuadri të përbashkët për dimensionin rinor të shërbimeve.



8.3 Karakteristikat kryesore të sistemit aktual

Nga analiza e kuadrit institucional, politikave dhe mënyrës së ofrimit të shërbimeve për të rinjtë në Shqipëri, sistemi aktual paraqet disa karakteristika kryesore:

- **Qasje shumë-nivelesh** - Politikat dhe shërbimet për të rinjtë zhvillohen në disa nivele të qeverisjes, duke përfshirë nivelin qendror dhe vendor.
- **Organizim ndërsektorial** - Shërbimet për të rinjtë nuk kufizohen në një sektor të vetëm, por ofrohen përmes institucioneve dhe programeve të ndryshme sektoriale.
- **Shpërndarje e shërbimeve ndërmjet ofruesve të ndryshëm** - Shërbimet dhe mundësitë për të rinjtë ofrohen nga institucione publike qendrore dhe vendore, institucione sektoriale, qendra dhe hapësira rinore, organizata të shoqërisë civile dhe organizata rinore, si dhe aktorë të tjerë jopublikë.
- **Rëndësia e nivelit vendor** - Bashkitë në varësi të kapaciteteve dhe prioriteteve lokale, ato mund të mbështesin hapësira rinore, aktivitete, shërbime sociale, programe të edukimit joformal, iniciativa komunitare dhe mekanizma të pjesëmarrjes së të rinjve.
- **Ekzistenca e mekanizmave për pjesëmarrjen e të rinjve** - KVR, organizatat rinore dhe mekanizmat e konsultimit krijojnë kanale për përfshirjen e të rinjve në identifikimin e nevojave, konsultimin e politikave dhe proceset vendimmarrëse.
- **Korniza e përbashkët për ShMR** - Megjithëse ekzistojnë standarde, rregulla dhe kërkesa sektoriale për shërbime të ndryshme, ato nuk formojnë një kornizë të përbashkët që përcakton kriteret e ShMR në mënyrë horizontale.
- **Ndërthurje e shërbimeve fizike dhe digjitale** - Aksesi në shërbime realizohet përmes pikave fizike të ofrimit, strukturave komunitare dhe kanaleve të tjera të kontaktit, ndërsa kanalet digjitale po marrin një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në informim dhe akses.
- **Varësi nga kapacitetet dhe kushtet territoriale** - Mënyra dhe niveli i ofrimit të shërbimeve mund të ndryshojnë ndërmjet bashkive dhe territoreve, në varësi të kapaciteteve institucionale, burimeve financiare, strukturave ekzistuese dhe partneriteteve lokale.
- **Nevojë për koordinim më të fortë dhe orientim ndërmjet shërbimeve** - Shpërndarja e shërbimeve ndërmjet sektorëve dhe ofruesve të ndryshëm krijon nevojën për mekanizma që e ndihmojnë të riun të identifikojë shërbimin e duhur, të marrë informacion të qartë dhe, kur është e nevojshme, të referohet drejt një shërbimi tjetër.
- **Qasja ndaj ShMR** - Modeli aktual krijon një bazë mbi të cilën mund të ndërtohet një qasje më e unifikuar ndaj ShMR. Kjo qasje mund të shërbejë si një kornizë plotësuese ndaj standardeve sektoriale, duke vendosur në qendër përvojën, nevojat dhe pjesëmarrjen e të riut.

8.4 Vlerësimi i përshtatjes së praktikave ndërkombëtare për Shqipërinë

Analiza e modeleve të përzgjedhura në Itali, Gjermani dhe Greqi tregon se secili prej tyre ofron elemente që mund të jenë me interes për zhvillimin e ShMR në Shqipëri. Megjithatë, këto elemente

nuk mund të transferohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi janë zhvilluar brenda sistemeve të ndryshme ligjore, institucionale, financiare dhe sociale. Për këtë arsye, përshtatja duhet të kuptohet si proces i përkthimit të parimeve dhe funksioneve të vlefshme të këtyre modeleve në strukturat dhe mekanizmat ekzistues shqiptarë, dhe jo si kopjim i një modeli të huaj.

Në këtë drejtim, nga modeli italian është veçanërisht me interes funksioni i hapësirës rinore si pikë aksesi për informacion, orientim, aktivitete dhe ndërveprim me komunitetin. Për Shqipërinë, ky funksion mund të forcohet përmes qendrave dhe hapësirave rinore ekzistuese, pa kërkuar domosdoshmërisht krijimin e strukturave të reja.

Nga modeli gjerman është me interes lidhja ndërmjet planifikimit vendor, koordinimit dhe rrjetit të ofruesve. Për Shqipërinë, ky element është i rëndësishëm në vlerësimin e rolit që mund të ketë niveli vendor në identifikimin e nevojave të të rinjve, planifikimin e shërbimeve dhe bashkërendimin e aktorëve që ofrojnë mbështetje për të rinjtë.

Nga modeli grek është me interes orientimi i shërbimit drejt nevojave konkrete të përdoruesit, veçanërisht përmes kombinimit të mbështetjes profesionale, informimit, këshillimit, parandalimit dhe referimit. Këto elemente mund të përdoren për të përmirësuar mënyrën se si shërbimet ekzistuese identifikojnë nevojat e të rinjve dhe i lidhin ata me shërbimet e duhura.

Përtej dallimeve ndërmjet modeleve, analiza nxjerr në pah disa elemente që mund të konsiderohen të transferueshme në kontekstin shqiptar: qasshmëria, orientimi drejt përdoruesit, pjesëmarrja e të rinjve, koordinimi ndërmjet shërbimeve, informimi i qartë, përfshirja, profesionalizmi dhe përmirësimi i vazhdueshëm.

8.4.1 Qasja e përshtatjes për Shqipërinë

Nga analiza e kontekstit shqiptar, përshtatja e ShMR duhet të nis nga sistemi ekzistues dhe jo të krijojë një sistem paralel. Procesi mund të nisë me identifikimin e shërbimeve dhe strukturave me rëndësi për të rinjtë, vlerësimin e përvojës së përdoruesve dhe evidentimin e pengesave që kufizojnë aksesin, informimin, pjesëmarrjen ose përdorimin efektiv të shërbimit. Mbi këtë bazë mund të përcaktohen ndryshimet e nevojshme në mënyrën e informimit, komunikimit, ofrimit, referimit dhe përfshirjes së të rinjve.

Përshtatja mund të shihet në tri nivele të ndërlidhura. Në nivelin e përdoruesit, fokusi vendoset te përvoja e të riut, qasshmëria, kuptueshmëria e informacionit dhe mundësia për të shprehur nevojat dhe për të dhënë reagime. Në nivelin e ofrimit, vëmendja përqendrohet te mënyra se si organizohen dhe ofrohen shërbimet, duke përfshirë komunikimin, kanalet e aksesit, procedurat, oraret, kapacitetet e stafit dhe mekanizmat e referimit. Në nivelin e sistemit, fokusi lidhet me koordinimin ndërinstitucional, planifikimin, standardet e përbashkëta, mekanizmat e pjesëmarrjes, financimin dhe monitorimin.

Kjo qasje e vendos ShMR si një dimension përmirësues të shërbimeve ekzistuese, dhe jo si një kategori të re shërbimesh. Zbatimi mund të jetë gradual, duke nisur nga ndryshime të realizueshme

në mënyrën e aksesit, informimit dhe komunikimit dhe duke vijuar, sipas nevojës, me ndryshime në organizim, koordinim dhe mekanizmat e monitorimit. Në këtë mënyrë, përshtatja mund të lidhet me kapacitetet dhe kushtet reale të institucioneve dhe territoreve, ndërsa përvoja e të rinjve përdoret si një nga burimet kryesore për identifikimin e nevojave dhe përmirësimin e shërbimeve.

8.4.2 Përfundimi i vlerësimit

Në tërësi, analiza krahasuese tregon se Shqipëria nuk ka nevojë të kopjojë një nga modelet e analizuara, por mund të përfitojë nga funksione dhe parime të ndryshme që ato ofrojnë. Nga modeli italian rezulton me interes afërsia me komunitetin dhe roli i hapësirave rinore si pika aksesi, informacioni dhe ndërveprimi; nga modeli gjerman, planifikimi sipas nevojave, koordinimi dhe lidhja ndërmjet aktorëve dhe ofruesve të ndryshëm; ndërsa nga modeli grek, orientimi i shërbimit drejt nevojave të përdoruesit, mbështetja profesionale dhe mekanizmat e referimit.

Këto elemente mund të përbëjnë pjesë të një qasjeje shqiptare ndaj ShMR, e cila ndërtohet mbi strukturat dhe shërbimet ekzistuese dhe i përshtat ato në funksion të nevojave dhe përvojës së të rinjve. Në këtë kuptim, ShMR mund të trajtohen si një qasje horizontale për përmirësimin e mënyrës së projektimit, aksesimit, ofrimit, koordinimit dhe vlerësimit të shërbimeve, duke plotësuar dhe jo zëvendësuar standardet dhe kërkesat sektoriale.

Qasja e propozuar synon kështu të krijojë një lidhje më të qartë ndërmjet përdoruesit, ofrimit dhe sistemit: nevojat dhe përvoja e të rinjve duhet të informojnë mënyrën se si shërbimet organizohen; ofruesit duhet të kenë mekanizma për informim, akses, mbështetje dhe referim; ndërsa sistemi duhet të sigurojë koordinim, standarde të përbashkëta, pjesëmarrje, monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Detajimi i mënyrës se si këto elemente mund të përshtaten në Shqipëri, strukturat ku mund të aplikohen, ndryshimet e nevojshme, aktorët përgjegjës dhe kushtet e zbatimit paraqitet në Aneksin nr. 1 “Matrica e përshtatjes së praktikave ndërkombëtare për Shqipërinë”.

9. REKOMANDIME PËR KONTEKSTUALIZIMIN NË SHQIPËRI

Në kontekstin shqiptar, rekomandimet e mëposhtme synojnë të krijojnë një qasje të integruar ndaj ShMR, duke u mbështetur në strukturat ekzistuese dhe duke forcuar lidhjen ndërmjet kuadrit politik dhe strategjik, institucioneve, ofruesve të shërbimeve dhe vetë të rinjve. Rekomandimet dallojnë ndërmjet ndërhyrjeve që mund të realizohen përmes përshtatjes së praktikave ekzistuese dhe atyre që kërkojnë ndryshime institucionale, organizative, financiare ose rregullatore.

9.1 Legjislacioni dhe dokumentet strategjike

Zhvillimi i ShMR kërkon një kuadër të qartë që përcakton parimet, përgjegjësitë dhe standardet që duhet të respektohen në ofrimin e shërbimeve për të rinjtë. Në këtë drejtim rekomandohet të:

- shqyrtohet kuadri ekzistues ligjor dhe nënligjor për të identifikuar dispozitat që mund të mbështesin integrimin e parimeve të ShMR në shërbimet ekzistuese;
- përcaktohen dimensionet e ShMR: qasshmëria, përshtatshmëria, përfshirja, cilësia, pjesëmarrja;
- zhvillohen udhëzime/kritere të përbashkëta për ShMR, të cilat mund të përdoren nga institucionet qendrore, bashkitë dhe ofruesit e shërbimeve;
- shqyrtohet mundësia e integrimit të objektivave për ShMR në dokumentet strategjike përkatëse, përfshirë politikat rinore dhe dokumentet sektoriale;
- sigurohet që zhvillimi i ShMR të lidhet me politikat ekzistuese sektoriale.

Një dokument udhëzues kombëtar për ShMR do të mund të shërbente si instrument praktik për të përkthyer parimet e përgjithshme në kërkesa konkrete për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve.

9.2 Organizimi institucional

Përvoja e vendeve të analizuara tregon rëndësinë e një ndarjeje të qartë të roleve ndërmjet nivelit qendror, nivelit vendor dhe ofruesve të shërbimeve. Për Shqipërinë, kjo kërkon një mekanizëm që siguron koordinim pa krijuar struktura paralele të panevojshme. Rekomandohet:

- forcimi i rolit të AKR**,** si një aktor qendror në promovimin, koordinimin dhe mbështetjen e zhvillimit të ShMR;
- përcaktimi i rolit të AKR në orientimin e politikave dhe sigurimin e koherencës ndërmjet politikave rinore dhe shërbimeve;
- vlerësimi i mundësisë për krijimin ose formalizimin një mekanizmi ndërinstitucional për ShMR, me përfshirjen e institucioneve qendrore, përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe ofruesve;
- forcimi i rolit të bashkive në identifikimin e nevojave lokale të të rinjve, planifikimin e shërbimeve, koordinimin e ofruesve dhe monitorimin e aksesit dhe cilësisë;
- zhvillimi i mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet bashkive, institucioneve qendrore, shërbimeve publike dhe OJF të shoqërisë civile;
- përcaktimi i pikave të kontaktit dhe përgjegjësive për ShMR në nivel institucional e vendor.

Në këtë model, niveli qendror do të kishte rol në orientim, standardizim, koordinim dhe mbështetje, ndërsa niveli vendor do të kishte rol të rëndësishëm në identifikimin e nevojave, planifikimin dhe organizimin e ofrimit, në përputhje me kontekstin lokal.

9.3 Projektimi, organizimi dhe ofrimi i shërbimeve

Një nga mësimet kryesore nga praktikat ndërkombëtare është se shërbimi miqësor nuk përcaktohet vetëm nga lloji i shërbimit, por nga përvoja që ka përdoruesi gjatë aksesimit dhe përdorimit të tij. Rekomandohet:

- vlerësimi i nevojave të të rinjve përpara krijimit ose riorganizimit të shërbimit;
- përshtatja e procedurave, orareve, kanaleve të kontaktit dhe informacionit me mënyrën se si të rinjtë i përdorin shërbimet;
- përdorimi i hapësirave ekzistuese rinore si pika aksesi, informacioni, orientimi e referimi;
- zhvillimi gradual i modeleve me një ndalesë ose të pikave të integruara të aksesit, ku i riu mund të marrë informacion dhe orientim për më shumë se një shërbim;
- krijimi i rrugëve të qarta të referimit ndërmjet shërbimeve dhe institucioneve;
- përcaktimi i një procesi të qartë nga identifikimi i nevojës deri te orientimi, referimi, ndjekja dhe përfundimi i mbështetjes.

Qasja me një ndalesë nuk nënkupton domosdoshmërisht bashkimin fizik të të gjitha shërbimeve në një strukturë. Ajo mund të realizohet edhe përmes një pike të koordinuar informacioni dhe orientimi, e cila e lidh të riun me shërbimin përkatës.

9.4 Pjesëmarrja

Pjesëmarrja e të rinjve duhet të trajtohet si pjesë e mënyrës së planifikimit dhe përmirësimit të shërbimeve dhe jo vetëm si konsultim periodik. Rekomandohet:

- përfshirja sistematike e KKR, KVR, organizatave rinore dhe të shoqërisë civile në proceset konsultuese;
- përdorimi i konsultimeve me të rinjtë për identifikimin e nevojave dhe pengesave në akses;
- përfshirja e të rinjve në projektimin dhe testimin e shërbimeve të reja;
- përdorimi i fokus-grupeve, sondazheve, konsultimeve publike dhe mekanizmave digjitalë për mbledhjen e mendimeve;
- krijimi i mekanizmave të rregullt të marrjes së mendimit për përvojën e përdoruesve;
- kalimi gradual nga konsultimi drejt bashkëkrijimit, ku të rinjtë marrin pjesë në përcaktimin e mënyrës se si një shërbim duhet të funksionojë;
- dokumentimi dhe komunikimi i mënyrës se si mendimet e të rinjve janë marrë në konsideratë në vendimmarrje.

Parimi “Asgjë për të rinjtë, pa të rinjtë!” mund të përdoret si parim orientues për këtë proces, duke siguruar që pjesëmarrja të lidhet me vendimmarrje konkrete dhe jo vetëm me mbledhjen e mendimeve.

9.5 Gjithëpërfshirja

ShMR duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë të rinjtë, por një qasje e barabartë nuk nënkupton domosdoshmërisht trajtim identik. Rekomandohet:

- për secilin shërbim të identifikohen pengesat që mund të pengojnë aksesin e të rinjve;
- të përcaktohen masa konkrete për adresimin e tyre. Këto masa mund të përfshijnë akses fizik dhe digjital, informacion në forma të përshtatshme, shtrirje në komunitet, orare fleksibël, mbështetje në orientim dhe referim dhe bashkëpunim me organizatat që punojnë me grupet përkatëse.

Parimi "Të mos lëmë askënd pas" duhet të integrohet si pjesë e planifikimit, ofrimit dhe monitorimit të ShMR.

9.6 Komunikimi dhe digjitalizimi

Informacioni i kuptueshëm dhe i aksesueshëm është një komponent themelor i një ShMR. Rekomandohet:

- përdorimi i gjuhës së qartë, të kuptueshme dhe të përshtatur për të rinjtë;
- publikimi i informacionit në kanale të ndryshme, duke kombinuar kanalet fizike dhe digjitale;
- përdorimi i faqeve institucionale dhe rrjeteve sociale për informim dhe orientim;
- zhvillimi i përmbajtjes së përshtatur për mjetet e komunikimit;
- sigurimi që informacioni të jetë i përditësuar dhe të përmbajë qartë kriteret, procedurat, dokumentet, kostot dhe kontaktet përkatëse;
- zhvillimi gradual i mundësive për informim, aplikim, komunikim ose ndjekje online, sipas natyrës së shërbimit;
- studimi i mundësive për sisteme digjitale të orientimit dhe referimit ndërmjet shërbimeve;
- garantimi i qasshmërisë digjitale dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Digjitalizimi duhet të shihet si mjet për zgjerimin e aksesit dhe përmirësimin e komunikimit dhe jo si zëvendësim automatik i kanaleve fizike. Për të rinjtë që përballen me pengesa digjitale, duhet të mbahen në dispozicion edhe forma alternative të aksesit.

9.7 Monitorimi, Vlerësimi dhe Marrja e Mendimeve

Zhvillimi i ShMR kërkon një sistem të thjeshtë dhe të përdorshëm për të matur jo vetëm numrin e shërbimeve ose përdoruesve, por edhe cilësinë, qasshmërinë dhe rezultatet e tyre. Rekomandohet identifikimi i:

- treguesve për qasshmërinë, përfshirë përdorimin nga grupe të ndryshme të të rinjve;
- treguesve për përdorimin dhe shtrirjen e shërbimit;
- treguesve për cilësinë dhe kohën e ofrimit;
- treguesve për kënaqësinë dhe përvojën e përdoruesve;

- treguesve për rezultatet dhe ndryshimet që shërbimi synon të krijojë;
- treguesve për referimin dhe vazhdimësinë e mbështetjes;
- treguesve për pjesëmarrjen e të rinjve në projektimin dhe përmirësimin e shërbimit.

Marrja e mendimeve nga të rinjtë duhet të jetë pjesë e rregullt e procesit të monitorimit. Të dhënat e mbledhura duhet të përdoren për vendimmarrje dhe përmirësim, dhe jo vetëm për raportim.

9.8 Financimi dhe qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria e ShMR kërkon që financimi të mos mbështetet vetëm në projekte afatshkurtra, por kërkon kombinimin e burimeve publike dhe të partneriteteve, duke përshtatur mekanizmat e financimit me natyrën e shërbimit. Rekomandohet:

- integrimi gradual i kostove të ShMR në planifikimin dhe buxhetimin publik;
- përdorimi i buxhetit të shtetit për funksionet dhe mekanizmat me rëndësi kombëtare;
- përfshirja e ShMR në buxhetet e bashkive, sipas nevojave dhe prioriteteve lokale;
- përdorimi i granteve dhe skemave të financimit për pilotimin dhe zhvillimin e modeleve të reja;
- nxitja e bashkëfinancimit ndërmjet nivelit qendror, vendor dhe partnerëve të tjerë;
- zhvillimi i partneriteteve me organizatat e shoqërisë civile, institucionet arsimore, sektorin privat dhe aktorë të tjerë, sipas natyrës së shërbimit;
- lidhja e financimit me objektiva, rezultate dhe tregues të përcaktuar;
- vlerësimi i qëndrueshmërisë së çdo modeli të ri përpara zgjerimit të tij.

Në rastet kur një shërbim pilotohet përmes financimit të jashtëm ose për herë të parë, duhet që në fazën e projektimit të përcaktohet se çfarë ndodh pas përfundimit të financimit, kush do të marrë përsipër funksionet, cilat kosto do të vazhdojnë dhe nga cili burim do të mbulohen.

10. Përmbledhja e rekomandimeve

Analiza e modeleve të përzgjedhura tregon se ShMR nuk përbëjnë një kategori të veçantë ose të unifikuar shërbimesh, por një qasje ndaj mënyrës se si shërbimet planifikohen, organizohen, ofrohen dhe përmirësohen në përgjigje të nevojave të të rinjve. Megjithëse sistemet e analizuara ndryshojnë në organizimin institucional, nivelin e decentralizimit, mënyrat e financimit dhe llojet e shërbimeve, ato ndajnë disa parime të rëndësishme që janë relevante edhe për kontekstin shqiptar.

I. Çfarë mësojmë nga tre vendet

- Nga modeli italian del në pah rëndësia e hapësirave dhe shërbimeve të afërta me komunitetin, të cilat mund të funksionojnë si pika aksesi, informacioni, orientimi, aktiviteti dhe lidhjeje të të rinjve me komunitetin. Përvoja e QAR tregon se një shërbim rinor mund të ndërtohet edhe duke përshtatur dhe aktivizuar struktura ekzistuese, duke krijuar një mjedis më të aksesueshëm dhe më të përshtatur me nevojat e të rinjve.
- Nga modeli gjerman del në pah rëndësia e organizimit të decentralizuar, planifikimit vendor dhe koordinimit të shërbimeve. Përvoja e Jugendhilfe dhe e punës së hapur rinore tregon rëndësinë e lidhjes ndërmjet identifikimit të nevojave, planifikimit, financimit, ofrimit të shërbimeve dhe pjesëmarrjes së të rinjve. Kjo nxjerr në pah rolin e rëndësishëm që mund të ketë niveli vendor në krijimin e shërbimeve që u përgjigjen kushteve dhe nevojave të komunitetit.
- Nga modeli grek del në pah rëndësia e orientimit të shërbimit drejt nevojave të përdoruesit, qasjes multidisiplinare dhe mekanizmave të parandalimit, mbështetjes dhe referimit. Përvoja e Njësive të Shëndetit për Adoleshentët tregon rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet profesionistëve dhe sektorëve të ndryshëm, si dhe të krijimit të lidhjeve funksionale me shërbime të tjera, në varësi të nevojave të përdoruesit.

Përtej dallimeve ndërmjet tyre, të tre modelet tregojnë se një ShMR funksional kërkon një kombinim të qasshmërisë, përshtatshmërisë, përfshirjes, cilësisë, pjesëmarrjes dhe elementeve si informacionit, koordinimit, cilësisë dhe mekanizmave të vazhdueshëm të përmirësimit. Këto elemente nuk funksionojnë të izoluara, por si pjesë e një sistemi të ndërlidhur.

II. Nga modelet te përshtatja në Shqipëri

- Disa elemente mund të përshtaten në Shqipëri me ndryshime relativisht të kufizuara. Këtu përfshihen veçanërisht: informacioni i qartë dhe i përshtatur për të rinjtë; përdorimi i kanaleve digjitale dhe i rrjeteve sociale; konsultimi dhe përfshirja e të rinjve; mekanizmat e rregullt të marrjes së mendimit; përshtatja e orareve, procedurave dhe mënyrave të kontaktit; përdorimi i hapësirave ekzistuese rinore si pika informacioni, orientimi dhe aktiviteti; përfshirja e perspektivës së të rinjve në projektimin dhe përmirësimin e shërbimeve; përdorimi i të dhënave dhe mendimeve të përdoruesve për përmirësimin e vazhdueshëm.
- Disa elemente kanë potencial të rëndësishëm transferimi, por kërkojnë ndryshime në mënyrën e organizimit të shërbimeve. Këtu përfshihen mekanizmat vendorë të koordinimit,

hartëzimi i shërbimeve, procedurat e referimit, bashkëpunimi ndërinstitucional, planifikimi i bazuar në nevoja dhe qasjet e shtrirjes.

III. Çfarë duhet përshtatur në kontekstin shqiptar

- Përshtatja duhet të fokusohet fillimisht në forcimin e strukturave ekzistuese, dhe jo në krijimin e një sistemi paralel shërbimesh rinore. Kjo nënkupton qartësimin e roleve ndërmjet nivelit qendror dhe vendor, forcimin e rolit koordinues të institucioneve përgjegjëse për rininë, përfshirjen e bashkive në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe krijimin e lidhjeve më funksionale ndërmjet ofruesve.
- Në lidhje me përshtatjen e kuadrit rregullator dhe strategjik për të krijuar një referencë të përbashkët për ShMR, nevojitet që standardet dhe udhëzimet të jenë të mjaftueshme për të siguruar një nivel të përbashkët cilësie, por edhe fleksibël për t'u zbatuar në kontekste të ndryshme vendore.
- Përshtatja e mekanizmave të financimit dhe qëndrueshmërisë kërkon që krijimi i modeleve të reja të vlerësohet jo vetëm për mundësinë e pilotimit, por edhe për mënyrën se si mund të financohet dhe të institucionalizohet pas përfundimit të financimit fillestar. Për këtë arsye, qëndrueshmëria duhet të konsiderohet që në fazën e projektimit të shërbimit.

IV. Drejt Shërbimeve Miqësore për të Rinjtë në Shqipëri

- Në nivelin e përdoruesit, prioritet duhet të jetë përmirësimi i aksesit, informacionit, komunikimit, përfshirjes dhe pjesëmarrjes së të rinjve. Shërbimet duhet të jenë të kuptueshme, të arritshme dhe të përshtatura me rrethanat e ndryshme të përdoruesve.
- Në nivelin e ofrimit, duhet të forcohen mënyrat e projektimit dhe organizimit të shërbimeve, kapacitetet e ofruesve, mekanizmat e referimit dhe bashkëpunimi ndërmjet shërbimeve. Në këtë kuadër, mund të zhvillohen gradualisht pika të integruara informacioni dhe orientimi, të cilat mund të funksionojnë edhe si një funksion koordinues dhe referues, pa kërkuar domosdoshmërisht krijimin e një strukture të re fizike.
- Në nivelin e sistemit, nevojitet një kuadër më i qartë institucional dhe rregullator, mekanizma koordinimi, standarde të ShMR, financim më të qëndrueshëm dhe mekanizma monitorimi dhe vlerësimi që matin jo vetëm aktivitetet dhe numrin e përdoruesve, por edhe qasshmërinë, përvojën e të rinjve, cilësinë, rezultatet dhe përdorimin e reagimeve për përmirësim.

Aneksi nr. 1 – "Matrica e përshtatjes së praktikave ndërkombëtare për Shqipërinë"

Fusha / elementi	Modeli burim	Çfarë mund të merret si mësim	Niveli i përshtatjes në Shqipëri	Veprimi i mundshëm i përshtatjes	N
Pika e aksesit për të rinjtë	Itali–QAR	Hapësirat rinore mund të funksionojnë si pika informacioni, orientimi, aktiviteti dhe ndërveprimi	Brenda strukturave ekzistuese	Vlerësimi dhe forcimi i funksioneve të hapësirave ekzistuese rinore	Pë
Informimi dhe orientimi	Itali/Greqi	Informacioni i qartë dhe i aksesueshëm lehtëson përdorimin e shërbimeve	Brenda strukturave ekzistuese	Përmirësimi i përmbajtjes, gjuhës, kanaleve dhe mënyrës së prezantimit të informacionit	Pë
Planifikimi sipas nevojave	Gjermani–Jugendhilfe	Planifikimi lidhet me nevojat e territorit dhe kapacitetet e ofruesve	Institucionale/organizative	Integrimi i nevojave të të rinjve në proceset e planifikimit vendor të shërbimeve	Si
Hartëzimi i shërbimeve	Gjermani/Itali	Identifikimi i shërbimeve dhe aktorëve lehtëson orientimin dhe koordinimin	Brenda strukturave ekzistuese	Krijimi ose përditësimi i hartave të shërbimeve dhe pikave të kontaktit	Si
Koordinimi ndërinstitucional	Gjermani	Lidhja ndërmjet institucioneve publike dhe ofruesve të ndryshëm rrit koherencën e shërbimeve	Institucionale/organizative	Përcaktimi i kanaleve të koordinimit, roleve dhe përgjegjësive	Si
Referimi ndërmjet shërbimeve	Greqi/Gjermani	Përdoruesi duhet të mund të orientohet drejt shërbimit më të përshtatshëm sipas nevojës	Institucionale/organizative	Identifikimi i pikave të kontaktit, procedurave bazë të referimit dhe, sipas rastit, ndjekjes së rastit	O
Orientimi nga nevojat e përdoruesit	Greqi–NjShA	Organizimi i shërbimit merr në konsideratë nevojat konkrete të përdoruesit	Brenda strukturave ekzistuese	Përfshirja e perspektivës së të rinjve në projektimin, përshtatjen dhe vlerësimin e shërbimeve	Pë
Qasshmëria	Të tre modelet	Ajo lidhet jo vetëm me hapësirën fizike, por edhe me informacionin, kohën, kostot dhe kanalet digjitale	Brenda strukturave / Institucionale	Identifikimi i pengesave dhe përshtatja e mënyrës së aksesit sipas karakteristikave të shërbimit	Pë
Pjesëmarrja e të rinjve	Të tre modelet	Pjesëmarrja mund të përdoret për identifikimin e nevojave dhe përmirësimin e shërbimeve	Brenda strukturave / Sistemi	Lidhja më sistematike e mekanizmave të pjesëmarrjes me planifikimin dhe vlerësimin e shërbimeve	Pë
Komunikimi dhe gjuha	Itali/Greqi	Mënyra e komunikimit ndikon në kuptimin dhe përdorimin e shërbimit	Brenda strukturave ekzistuese	Përdorimi i një gjuhe të qartë, të kuptueshme dhe jo stigmatizuese	Pë

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

Kombinimi i kanaleve fizike dhe digjitale	Itali/Greqi	Kanalet digjitale mund të plotësojnë dhe zgjerojnë aksesin fizik	Brenda strukturave ekzistuese	Zhvillimi i kanaleve digjitale duke ruajtur alternativa fizike për përdoruesit që përballen me pengesa digjitale	Pë
Përfshirja dhe adresimi i pengesave	Të tre modelet	Shërbimet duhet të marrin në konsideratë pengesa të ndryshme që ndikojnë në akses dhe përdorim	Brenda strukturave/Institucionale	Identifikimi i pengesave specifike dhe përshtatja e informacionit, aksesit dhe mënyrës së ofrimit	Pë
Kapacitetet profesionale	Gjermani/Greqi	Cilësia e shërbimit lidhet edhe me kompetencat e stafit dhe bashkëpunimin profesional	Institucionale/organizative	Identifikimi i kompetencave të nevojshme dhe planifikimi i zhvillimit profesional	O
Reagimet e përdoruesve	Të tre modelet	Përvoja e përdoruesve mund të përdoret si burim për përmirësimin e shërbimit	Brenda strukturave ekzistuese	Krijimi i mekanizmave të rregullt për mbledhjen, analizimin dhe përdorimin e reagimeve	Pë O
Monitorimi dhe vlerësimi	Të tre modelet	Monitorimi duhet të shkojë përtej matjes së aktiviteteve dhe të marrë në konsideratë aksesin, cilësinë dhe rezultatet	Institucionale/Sistemi	Integrimi gradual i treguesve të ShMR në mekanizmat ekzistues të monitorimit dhe raportimit	Si
Financimi dhe qëndrueshmëria	Itali/Gjermani	Vazhdimësia e shërbimeve kërkon mbështetje institucionale dhe financiare	Zhvillim sistemik	Përfshirja e kostove dhe funksioneve të shërbimeve në planifikimin dhe buxhetimin publik, sipas rastit	Si
Kuadri i përbashkët për ShMR	Elemente nga të tre modelet	Parimet e përbashkëta mund të plotësojnë standardet ekzistuese sektoriale	Zhvillim sistemik	Hartimi i udhëzimeve ose kritereve të përbashkëta për ShMR, pa zëvendësuar kërkesat sektoriale	Si
Koordinimi qendror-vendor	Të tre modelet	Lidhja ndërmjet politikës qendrore dhe zbatimit vendor është e rëndësishme për koherencën e shërbimeve	Zhvillim sistemik	Forcimi i mekanizmave të koordinimit dhe përcaktimi më i qartë i roleve në zbatim, monitorim dhe përmirësim	Si

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union